

ANALIZA E PREMTIMEVE ZGJEDHORE E SUBJEKTEVE POLITIKE TË RINJTË - ZGJEDHJET 2024



Analiza e përfshirjes së çështjeve në lidhje me të rinjtë në programet e kandidatëve për President dhe në programet zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve

dhe

Analiza e përfshirjes së çështjeve në lidhje me të rinjtë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 Shkup, gusht 2024

Zbatuar nga:



International Foundation
for Electoral Systems



Përmbajtje

01

Hyrje

02

Përfaqësimi i çështjeve rinore në programet e kandidatëve për President

Përfshirja e çështjeve në lidhje me rininë

03

Përfundime përmbyllëse nga programet e kandidatëve për President

04

Përfaqësimi i çështjeve rinore në programet zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare

Përfshirja dhe trajtimi i çështjeve në lidhje me rininë

Fokusi i çështjeve në lidhje me të rinjtë

05

Përfundime përmbyllëse nga programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare

06

Rekomandime

07

Pasqyrë e përfshirjes së premtimeve për rininë në Programin e punës së Qeverisë 2024 - 2028

Analiza krahasimore e përfshirjes dhe trajtimit të çështjeve në lidhje me rininë

08

Përfundime përmbyllëse nga analiza krahasimore

09

Rekomandime

Kjo analizë është zhvilluar në kuadër të Programit për mbështetjen zgjedhore të qeverisë së Zvicrës, zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). Pikëpamjet, opinionet dhe përmbajtja e shprehur në këtë prezantim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorit, projektit ose realizuesit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2024 u zbatuan zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Zgjedhjet presidenciale u realizuan në rrethin e parë më 24 prill, ndërkaq rrethi i dytë u realizua më 8 maj së bashku me zgjedhjet parlamentare. Gjatë fushatës parazgjedhore për Presidentin e shtetit qytetarët patën mundësi që të njihen përsëafërmi me përcaktimet strategjike dhe me synimet e kandidatëve për President që u prezantuan në programet e tyre, ndërkaq fushata parazgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend i afrooi te qytetarët programet zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve.

Lënda e kësaj analize është e paraqitur në dy shkallë:

1. Përfaqësimi i rinisë në programet e kandidatëve për President dhe në programet zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve për zgjedhjet parlamentare. Në atë rast analiza i ka marrë parasysh programet e mëposhtme të partive politike dhe të kandidatëve për President^[1]:

- VMRO – DPMNE, Platforma “Maqedonia përsëri krenare” dhe kandidatja e tyre Gordana Siljanovska Davkova dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare i titulluar “Platforma # 1198”.
- LSDM dhe Koalicioni për Ardhmërinë Evropiane, programi zgjedhor i kandidatit për President Stevo Pendarovski „Presidenti ynë Stevo“ dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare i titulluar “Programi për ardhmërinë evropiane 2024”.
- Fronti Evropian, Dekalogu i Presidentit Evropian me kandidatin për President Bujar Osmani dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare “Evropa 2030”.
- Koalicioni Vlen, programi zgjedhor i kandidatit për President Arben Taravari „Platforma presidenciale“ dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare “Plani 2030”.
- E majta – Levica, programi zgjedhor i kandidates për Presidente Biljana Vankovska “E kthejmë dinjitetin e kombit” dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare “Të pakorruptueshmit në Kuvend”.
- GROM, programi zgjedhor “Trimërisht për Maqedoninë” i kandidatit për President Stevço Jakimovski.
- (Programi i kandidatit për President, Maksim Dimitrievski, nuk kishte qasje onlajn)

[1] Emërtimet e programeve dhe emrat e subjekteve politike janë marrë nga kopertinat e programeve të kandidatëve për President dhe programeve zgjedhore për zgjedhjet parlamentare. Në këtë mënyrë do të përdoren në mënyrë të njëkuptimshme nëpër tërë dokumentin. Gjithashtu, terminologjia që përdoret në këtë dokument në lidhje me emërtimet zyrtare, siç është emri i shtetit, përdoret në mënyrë identike siç është përdorur në programet zgjedhore të kandidatëve për President dhe në programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare.

2. Përfshirja dhe trajtimi i në lidhje me rininë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 me ç’rast kjo analizë i mori parasysh programet zgjedhore të subjekteve politike që e përbëjnë Qeverinë d.m.th.:

- Programin zgjedhor të VMRO–DPMNE–së “Platforma # 1198”.
- Programin zgjedhor të Koalicionit VLEN “Plani 2030”.
- Programin zgjedhor të Lëvizjes ZNAM „Manifest për Maqedoni të denjë”.

Çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë janë bartur nga një cikël zgjedhor në tjetrin në programet zgjedhore të subjekteve politike në formë të njëjta a të ngjashme. Në anën tjetër, analizat e shumta tregojnë se realizimi i premtimeve lidhur me të rinjtë dhe çështjet rinore gjithashtu ka qenë në shkallë të ulët. Kjo gjë tregon se këto çështje janë trajtuar sipërfaqësisht, ndonjëherë në nivelin e zotimeve deklarative dhe në mungesë të analizës më të detajuar rreth asaj se cilat janë nevojat e mirëfillta, detyrimet e ndërmarra ndërkombëtare dhe standardet tanimë të vendosura në suazat e kornizës ligjore. Andaj, në këtë cikël zgjedhor është e rëndësishme të shqyrtohet vallë ka ndonjë strategji, gjegjësisht cila është strategjia e subjekteve politike lidhur me çështjet rinore dhe të propozohen në mënyrë adekuate rekomandimet e caktuara për implementimin e më tejme të masave konkrete dhe të politikave, si në shkallë kombëtare, ashtu edhe në atë vendore. Pikërisht kjo është një nga qëllimet e kësaj analize, e cila zbatimin e saj do ta gjejë në diskutimin publik në lidhje me zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, por edhe në periudhën para dhe gjatë zgjedhjeve të ardhme lokale në vitin 2025.

02 Përfaqësimi i çështjeve rinore në programet e kandidatëve për President

Nga analiza e përgjithshme e programeve të kandidatëve për Presidentin e shtetit mund të arrihet në përfundim se në përputhje me kompetencat që i mban ky post, fokusi është vënë në rendin kushtetues, sundimin e ligjit dhe drejtësinë, ruajtjen e sigurisë dhe identitetit kombëtar, politikën e jashtme, anëtarësimin në NATO dhe unifikimin e shtetit, ndërsa më pak në çështjet dhe politikat multisektoriale, siç janë çështjet rinore.

Megjithatë, në programet e partive politike, siç janë: LSDM dhe Koalicioni për Ardhmërinë evropiane, VMRO–DPMNE dhe Fronti Evropian ose koalicioni VLEN, mund të vërehen edhe çështjet që kanë të bëjnë me rininë. Në vazhdim vijon një paraqitje e shkurtër e përfshirjes së këtyre çështjeve në programet e kandidatëve për President.

Përfshirja e çështjeve në lidhje me rininë

Rinia dhe çështjet në lidhje me të rinjtë janë përfaqësuar me shtrirje të ndryshme në programet e të gjithë kandidatëve përveç në programin e kandidatës së partisë „Levica” dhe kandidatit të Koalicionit VLEN ku përmenden vetëm tërthorazi. Me fjalë të tjera, në programin e kandidatës së „Levicës” në lidhje me të rinjtë është përmendur se ndër vite është krijuar një diasporë e re rinore, kapacitetet e së cilës ende nuk njihen, e të cilët kanë potencial për t’u bërë ambasadorët tanë më të mirë. Nga ana tjetër, në programin e kandidatit të Koalicionit Vlen prezantohet formimi i shkollave novatore me të cilat do të udhëhiqte kabineti i Presidentit. Në programin e kandidatit të GROM–it të rinjtë nuk janë veçuar aspak me masa dhe zotime të veçanta.

Dekalogu i Presidentit Evropian, Fronti Evropian

Programi i kandidatit të Frontit Evropian, parasheh „formimin e ekipit të posaçëm për krijimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave rinore të shtetit“, dhe krijimin e pozitës „Këshilltar i Presidentit për çështje rinore“.

Fragment nga Dekalogu i Presidentit Evropian, Bujar Osmani, Fronti Evropian

Në programin e kandidatit të Frontit evropian ka 10 zotime që kanë të bëjnë me prioritetet e ndryshme me ç’rast është ndarë veças një seksion/zotim për të rinjtë i titulluar Plani shtetëror për perspektivën e të rinjve dhe mbajtjen e tyre në vend. Në këtë pjesë kandidati për President zotohet se do të krijojë perspektiva për të rinjtë nëpërmjet mundësive të shtuara për arsim, por edhe masa aktive për sipërmarrësi, start-up-e dhe përfshirje në rrjedhat bashkëkohore të biznesit, në mënyrë që të mbahet fokusi

i të rinjve në aktivitetet dhe potencialet që i ofron vendi“. Në kuadër të këtij seksioni janë paraparë mekanizma me të cilat Presidenti do të kishte punuar drejtpërdrejt me/dhe për të rinjtë siç është ekipi i posaçëm për krijimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave rinore të shtetit dhe Këshilltari i Presidentit për këto çështje. Edhe pse ky seksion sipas titullit paralajmëron një plan të posaçëm, megjithatë ajo që është përfshirë në tekst është më tepër në nivelin e zotimeve sesa plane dhe zgjidhje konkrete për të gjithë të rinjtë në përputhje me kuadrin ligjor dhe politikat rinore të shtetit. Më tej, në pjesën/zotimin Arsimi dhe Inovacionet janë përfshirë zotimet për avancimin e arsimimit të rinisë në përputhje me prurjet dhe inovacionet teknologjike bashkëkohore, krijimin e modelit arsimor që do t’i ndjekë ndryshimet të kërkesa e fuqisë punëtore dhe shfaqja e vendeve të reja të punës të ndryshme nga të tanishmet, e për të cilat nxënësit dhe studentët tanë duhen të jenë të përgatitur, si dhe mundësinë e shfrytëzimit të potencialit të rinisë së vendit tonë që janë larguar jashtë shtetit. Në këtë pjesë përmendet se do të rritet buxheti për arsimin, shkencën dhe hulumtimin dhe se do të formohen qendra kërkimore shkencore në çdo universitet. Në pjesën/zotimin Marrëveshja ekonomike kornizë parashihet masa konkrete „Marrëveshje me dhjetë universitetet e biznesit më të ranguara në botë për dërgimin e studentëve më të mirë me bursë të plotë, me përparësi të kategorive më të rrezikuara të qytetarëve“. Këto masa tregojnë qasje konkrete në fuqizimin e të rinjve si kategori e rrezikuar.

Presidenti Ynë Stevo, LSDM dhe Koalicioni për ardhmërinë evropiane

Në programin e kandidatit për President të LSDM-së dhe të Koalicionit për ardhmëri evropiane gjithashtu ka një seksion të veçantë që i përkushtohet të rinjve. Në kuadër të këtij seksioni përmendet se të rinjtë kanë nevojë për mbështetje që të mund të realizojnë potencialin dhe talentin e tyre, dhe është obligim dhe detyrë e çdo institucioni dhe funksioni publik. Në program shënohet se tendencat demografike dhe migrimet kanë ndikuar në shpërnguljen e të rinjve, për këtë arsye nevojitet një fokusim më të madh masash se si të mbahet kontakti me të rinjtë të cilët ndodhen jashtë vendit dhe mundësia e përfshirjes së tyre në rrjedhat shoqërore të vendit tonë.

Në lidhje me të rinjtë ka dy masa konkrete që prezantohen në program:

- ✿ formimi i një organi të posaçëm këshillimor që do të angazhohej në uljen e tendencave negative demografike, në promovimin e politikave aktive demografike

Kandidati për President i LSDM-së dhe Koalicionit për ardhmërinë evropiane në programin e vet e identifikon vetveten si „ Promovues i të drejtave të rinisë, bashkësive të rrezikuara dhe të marginalizuara “.

Fragment nga programi zgjedhor „Presidenti Ynë Stevo“, i Stevo Pendarovski, LSDM dhe Koalicionit për ardhmërinë evropiane



- * formimi i një baze qendrore të dhënash për të gjithë të rinjtë të cilët arsimohen, përsosen apo dijen dhe shkathtësitë i zbatojnë përmes punës së tyre në kompanitë dhe organizatat e huaja, por edhe që të ruhet kontakti me të gjithë këta të rinj.

Gjithashtu, lidhur me të rinjtë përmendet edhe vazhdimi i traditës së Shkollës për liderët e rinj nën patronazhin e Presidentit, si dhe integrimin e arsimit politik në programet mësimore të shkollave të mesme. Kandidati për President i LSDM-së dhe Koalicionit për Ardhmërinë evropiane në programin e tij zotohet edhe për integrimin e Maqedonisë së Veriut në BE, me ç ‘rast theksohet se përfitimet e integritit të këtillë më së tepërmi do t’i shijojnë të rinjtë ,veçanërisht në politikat arsimore, zhvillimin teknologjik dhe politikat socio-ekonomike për përmirësimin e statusit të tyre social dhe ekonomik dhe në uljen e emigracionit.“

Maqedonia përsëri krenare, VMRO-DPMNE

Në programin e kandidatës së VMRO-DPMNE-së i përkushtohet një seksion i veçantë të rinjve me titullin Presidente mike e të rinjve. Të rinjtë definojnë si subjekte të politikës të cilët kanë potencialin e liderit dhe kontribuojnë në ndryshimet pozitive. Sëkëndejmi, programi i trajton të rinjtë jo vetëm në mënyrë deklarative dhe përmes zotimesh, por edhe përmes masash konkrete për pjesëmarrjen e tyre në proceset e konsultimeve dhe përmes krijimit të mundësive për promovimin e tyre në vend dhe jashtë vendit. Të rinjtë përmes këtij programi shihen si individë që duhet të angazhohen, të jenë aktivë dhe të cilët duhet të kontribuojnë në zhvillimin e kombit si në vend ashtu edhe në skenën ndërkombëtare.

Dy masa kyçe përmenden në lidhje me të rinjtë:

- * Vendorsjen e pozitës Këshilltar për të rinjtë në Kabinet i cili do të udhëheqë me të sapoformuarin Këshillin për të rinjtë, dhe
- * Formimin e Forumit për të rinjtë nën patronazhin e Presidentit. Forumi paramendohet ,si platformë e strukturuar që të dëgjohen zërat e tyre, Forumi do të synojë të nxisë një mjedis politik gjithëpërfshirës, dinamik dhe progresiv. Forumi do të punonte në realizimin e aktiviteteve në shumë fusha, si për shembull, arsim,kulturë, teknologji, sport etj.“

„Qëllimi im është fuqizimi i të rinjve - njohja e tyre si partnerë kyçë në formësimin e të ardhmes së republikës.“

Fragment nga programi zgjedhor Maqedonia përsëri krenare e Gordana Siljanovska Davkova, VMRO-DPMNE

Më tej, si masa vijuese prezantohen:

- * praktika për të rinjtë në Kabinetin e Presidentit
- * emërimi i të rinjve si Ambasadorë të vullnetit të mirë ,nga radhët e profesionistëve tanë të rinj të vendit dhe nga e mbarë bota, të cilët kanë ose ndërtojnë karriera të suksesshme në ekonominë ndërkombëtare, në politikë, në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në shkencë, ,dhe
- * vazhdimi i traditës së shkollës ndërkombëtare për liderët e rinj.

03

Përfundime përmbyllëse nga programet e kandidatëve për President

Nga ky vështrim i hollësishëm i programeve të kandidatëve për President mund të përfundohet se përfshirja e çështjeve multisektoriale, në përgjithësi është e pamjaftueshme.

E dukshme është përpjekja e një pjese të kandidatëve për President që në programet e tyre të gjejnë vend për të rinjtë dhe çështjet lidhur me ta. Megjithatë, ky është vetëm fillimi dhe bazë e mirë që në të ardhmen kandidatët për President të përfshijnë sa më tepër çështje të këtilla në punën e tyre dhe ta operacionalizojnë këtë përmes veprimit të tyre. Mund të thuhet se ata kandidatë që iu referuan të rinjve në programet e tyre duan t'u japin shansë të rinjve, duke shprehur besimin se të rinjtë mund dhe duhet të jenë mbështetje këshillimore e Presidentit edhe përmes organeve dhe pozitave të reja të formuara për të rinjtë dhe të udhëhequra nga të rinjtë, siç janë: këshillat, forumet, ambasadorët këshillimorë dhe ngjashëm, që të mund t'i prezantojnë nevojat e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrjet e rëndësishme kombëtare.

Integrimi i çështjeve për të rinjtë në kornizën kombëtare ligjore dhe institucionale është realitet, por duhet të forcohet implementimi i tyre në praktikë. Andaj, zotimet e kandidatëve për President për këto grupe të qytetarëve duhet të përforcohen dhe të shndërrohen në masa sa më konkrete, më tej përmes programit dhe masave të subjekteve politike që do të prezantohen në Qeverinë e re. Mesazhi dërgohet nga niveli më i lartë, nga pozita e Presidentit të shtetit, se çështjet që prekin të drejtat e të rinjve duhet të përfshihen në agjendën e institucioneve, në shkallë shtetërore dhe në shkallë vendore, domethënë jepet një shembull se si ato duhet të zbatohen denjësisht përmes ndarjes së burimeve adekuate njerëzore dhe financiare.

Analiza e programeve zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve për zgjedhjet parlamentare 2024 tregoi se në to janë përfaqësuar masa dhe politika që kanë të bëjnë me të rinjtë dhe gratë. Te disa subjekte politike siç janë „Levica”, këto masa dhe politika janë përfshirë kryesisht në kuadër të fushave/sectorëve të posaçëm, ndërkaq te të tjerat, siç janë: VMRO-DPMNE, Koalicioni VLEN dhe Fronti evropian, janë veçuar kapituj të posaçëm që i përkushtohen të rinjve. Kjo flet se subjektet politike, përpiqen të vendosin qasje strategjike për çështjet rinore.

Te programet mbizotërojnë masat e ngjashme, ndërsa te subjektet politike, të cilat kanë numër më të madh përfaqësuesish në Kuvend, është i pranishëm një spektër i gjerë masash dhe politikash të fushave të ndryshme. Por, çështjet kyçe për të rinjtë siç janë arsimi, punësimi, standardi dhe shëndetësia, mbështetja ekonomike dhe punësimi, si dhe masat sociale, janë të pranishme te të gjitha subjektet politike. Gjithashtu, në programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare mund të vërehen masa të cilat tashmë janë të pranishme ose janë duke u zbatuar, si dhe masa krejtësisht të reja ose shfuqizime të disa masave ekzistuese. Në vazhdim vijon analiza e hollësishme për përfshirjen e çështjeve rinore në programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare.

Përfshirja dhe trajtimi i çështjeve në lidhje me rininë Fokus politikat për çështjet në lidhje me të rinjtë

Çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë dominojnë si kapituj të veçantë ose si segmente pothuajse në të gjitha programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 2024 të cilat janë lëndë e kësaj analize. Përveç kësaj, rinia si kategori e veçantë, është përfshirë nëpër politikat e ndryshme sektoriale, para së gjithash në pjesën për arsimin dhe punësimin, bujqësinë, si dhe në transformimin digjital dhe në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Të rinjtë përmenden edhe në fjalët përshëndetëse të liderëve të partive politike dhe koalicioneve. Përfshirja e këtyre çështjeve në programet zgjedhore është prezantuar në dy pjesë: fokusi i çështjeve në lidhje me të rinjtë dhe politikat multisektorale për të rinjtë.

Pasqyra e përfshirjes së çështjeve në lidhje me të rinjtë është e ndarë në dy pjesë:

- Fokusi i çështjeve në lidhje me të rinjtë

dhe

- Politikat ndërsektorale për të rinjtë.

Platforma # 1198 të VMRO-DPMNE-së

Në Platformën # 1198 të VMRO-DPMNE-së fokus të çështjeve rinore ka në pjesën VI. Të drejtat dhe liritë segment i posaçëm Koha e të rinjve. Në kuadër të këtij segmenti parashikohen:

Ky segment programor përfshin shumë aspekte si më poshtë:



Masa ekonomike për të rinjtë siç janë: 70.000 të rinj të sapopunësuar, lirim nga tatimi i të ardhura personale për të rinjtë deri në 29 vjeç, ofertë e garantuar pune për 500 studentët më të mirë, punë me honorar për studentët, 5.000 trajnime njëvjeçare për të rinjtë nga fusha e TIK-ut, si dhe certifikatë të TIK profesionistëve, dhe 5 milionë euro për nisma sipërmarrëse për të rinjtë.



Në pjesën e Nxitjes së punësimit në profesionet e reja parashihet lidhja digjitale me botën, qendra e inovacionit digjital, mbështetja e voluntarizmit rinor në institucionet publike, e – vauçerë për trajnime plotësuese dhe arsim joformal. Një masë e veçantë orientohet kah fermerët e rinj deri në 40 vjeç ku parashihet mbështetja për 5.000 fermerë të rinj.

Në vend të retorikës dhe premtimeve boshe, VMRO-DPMNE ofron vizion për krijimin e kushteve të domosdoshme për të rinjtë e Maqedonisë për ta ndërtuar ardhmërinë në shtëpi, fuqizimin e tyre përmes arsimit dhe zhvillimit të shkathtësive, nxitjen e pjesëmarrjes rinore në proceset e vendimmarrjes dhe promovimin e sipërmarrësisë dhe inovacionit“.

Fragment nga programi zgjedhor Platforma #1198 e VMRO-DPMNE-së



Në pjesën Standardi rinor parashikohet aplikacioni celular përmes të cilit të gjithë të rinjtë do të kenë mundësi të shfrytëzojnë lirimet për hyrje në teatre, muze, institucione të fushës së kulturës, transport publik (i autobusëve dhe i hekurudhave), gara sportive dhe ngjarje tjera, si dhe masa e posaçme internet falas për të rinjtë në të gjitha konviktet e studentëve dhe nxënësve, biblioteka, leximore, qendra rinore dhe fakultete, sheshe dhe pika të tjera urbane.



Në pjesën Arsimi dhe standardi evropian studentor premtohet rinovimi i të gjitha konvikteve të studentëve dhe të nxënësve , shujtë të denjë për të gjithë studentët, 50 milionë euro bursa për studentë dhe nxënës, e-biblioteka në fakultete, leximore, qendra të karrierës për të rinjtë.









Në pjesën Organizimi rinor dhe prezantimi në kuadër të riorganizimit ekzistues të ministrive premtohet në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe hapja e qendrave rinore në shumë qytete. Megjithatë, në këtë segment mungojnë masa konkrete për zbatimin e përforcuar të Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore.

Programi për Ardhmërinë evropiane 2024 i LSDM-së dhe Koalicionit për ardhmëri evropiane

Në këtë program ka kapitull të veçantë VII. Të rinjtë – shtyllë e ardhmërisë, gjegjësisht Manifest rinor.

Janë përfshirë një sërë zotimesh dhe grup masash që kanë të bëjmë me përmirësimin e pozitës së të rinjve, por edhe forcimin e disa parimeve siç është barazia gjinore.

Ato janë:

-  Zotimi i parë është për Vende cilësore të punës në tregun konkurrues të punës përmes: të ardhurave minimale të përgjithshme, qasjes në vendet cilësore të punës, koncepti – Rrogë për jetesë.
-  Zotimi Qasje në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe trajnim premtan arsim të përballueshëm, të arritshëm dhe cilësor për të gjithë të rinjtë përmes: implementimit të Garancisë evropiane për fëmijët, programeve mësimore që nxisin kreativitetin, motivimin dhe mendimin kritik, futjes së arsimimit seksual gjithëpërfshirës në shkolla dhe mësimi joformal, si dhe trajnimit të përhershëm.
-  Zotimi për Standardin rinor ka të bëjë me avancimin e pjesëmarrjes rinore përmes: kujdesit për shëndetin mendor të rinisë, programeve për forcimin financiar të standardit jetësor të rinisë, transport publik të arritshëm dhe me qasje dhe formimin e Ministrisë së Rinisë.
-  Zotimi Duam të jetojmë në shtet funksional–sistemi të funksionojë për të gjithë premtan shoqëri pa korrupsion për vendosjen e tatimit progresiv për shoqëri të qëndrueshme, punë transparente të administratës publike, digjitalizimin e të gjitha proceseve institucionale dhe dokumenteve, gjyqësi efikase dhe të pavarur e çliruar nga ndikimet partiake dhe qasje universale në mbrojtje cilësore shëndetësore.
-  Zotimi për Strehim të përballueshëm, me qasje dhe të denjë do të realizohej përmes caktimit të shumës maksimale të çmimeve të tregut për qiradhënie të pasurive të paluajtshme, planit për strehim publik për të rinjtë deri në moshën 29 vjeç, programit me çmime të subvencionuara dhe të favorshme për blerjen e shtëpisë për të rinjtë deri në moshën 29 vjeç, jetesës së pavarur me asistencë të personave me aftësi të kufizuara, shtëpive me efikasitet energjetik të cilat do ta përmirësojnë gjurmën ekologjike të banimit.
-  Zotimi Barazi dhe përfshirje për ty. Dhe për të gjithë premtohet jetesa e liruar nga dhuna për çdonjëri, mundësi të barabarta në tregun e punës, përfaqësim i barabartë i grave në pozitë vendimmarrëse, shëndeti seksual dhe reprodiktiv dhe të drejtat, zotimi për realizimin e të drejtave të gruas rome dhe të drejta e personave me aftësi të kufizuara.

„Zotohemi për mundësi të barabarta, për jetesë cilësore e të denjë dhe prosperitet dhe luftojmë për shërbime publike cilësore e të arritshme, si dhe shërbime për qytetarët – strehim, shëndetësi, arsim, transport, të cilat duhet të kenë qasje universale për të gjithë qytetarët, e jo vetëm për ata me të ardhura më të larta.“

Fragment nga programi zgjedhor Programi për ardhmërinë evropiane 2024 i Koalicionit për ardhmëri evropiane

Evropa 2030 e Frontit Evropian

Në programin Evropa 2030 i Frontit Evropian fokus të çështjeve rinore ka në kapitullin 3 Marrëveshje për konsensus ekonomik segment i posaçëm, 3.5 Rini aktive dhe shoqëri të barabartë dhe pjesë e posaçme Rini aktive.

Në kuadër të kësaj pjese janë përfaqësuar zotimet dhe masat rinore për avancimin e pozitës së të rinjve:

-  Zotimi i përgjithshëm Rinia, kultura dhe sporti në kuadër të të cilit premtohet vendosja e përfaqësimit të barabartë në shpërndarjea e mjeteve për mbështetjen e organizatave të shoqërisë qytetare me fokus në mbështetjen e organizatave rinore që punojnë në çështjen e zhvillimit të romëve të rinj.
-  Më tej, siç përmendet, qëllimi i Frontit Evropian është ,të krijojmë dhe të implementojmë strategji integrale për të rinjtë, e cila do të sigurojë një mjedis ku të rinjtë do të mund ta zhvillojnë tërësisht potencialin e tyre, duke ofruar mbështetje në zbulimin e nevojave të tyre individuale dhe promovimin e talenteve, interesave dhe kreativitetit të tyre“.
-  Pjesëmarrje aktive të rinisë në vendimmarrje në më shumë nivele si për shembull në institucione, në krijimin dhe sjelljen e politikave, në arsim. Kjo do të zbatohet përmes implementimit dhe monitorimit të efekteve nga Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, si dhe rregullimi i pjesëmarrjes së të rinjve në shkollat e mesme përmes kornizës së re ligjore.
-  Mbështetet aktivizmi rinor, si dhe aktivizmi në mjedisin digjital përmes avancimit të arsimimit digjital dhe avancimit të shërbimit të mjeteve digjitale.
-  Mbështetet sektori rinor, e veçanërisht aktivitetet me të rinjtë e zonave rurale, puna e rinisë duke njohur profesionin punonjës me të rinjtë dhe ndërtimi i kapaciteteve në këtë drejtim.
-  Garantohet qasje e barabartë dhe arsim cilësor për të rinjtë.
-  Në pjesën forcimi ekonomik i të rinjve parashihet formimi i Këshillit kombëtar ndërsektorial që do të zotohet për një punë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme me rininë, aktivizimi i të rinjve që nuk janë në arsim dhe që nuk janë të punësuar (NEET), lidhja e biznesit me shkollat dhe fakultetet, mbështetja e sipërmarrësve dhe start up-ve.
-  Zotime për rritjen e cilësisë së jetës së të rinjve përmes promovimit të stileve të shëndosha jetësore, aktivitetit fizik dhe luftës kundër varësive.
-  Premtohet edhe lufta kundër dhunës dhe forcimi i sigurisë së të rinjve.

”

Vizioni i Frontit Evropian lidhur me të rinjtë është „Një shoqëri ku të rinjtë do të trajtohen si partnerë të barabartë në krijimin dhe zbatimin e politikave rinore, pa diskriminime dhe paragjykime“.

Fragment nga programi zgjedhor Evropa 2030 i Frontit për Evropë

Plani 2030 i Koalicionit VLEN

Në programin Plani 2030 i Koalicionit VLEN fokus në çështjet rinore ka në kapitullin VI. Rinia, arsimit dhe edukimi.

Në kuadër të këtij kapitulli ka më shumë segmente që përfshijnë zotime dhe masa për rininë:

- Në segmentin Fëmijët dhe të rinjtë – lojë, sport dhe kulturë premtohet ndërtimi i 200 terreneve sportive në vendbanimet shqiptare, 5 qendra kulturore shqiptare dhe mbështetje për sportistët elitare.
- Parashikohet që shkollat të bëhen qendra të komunitetit të pajisura me biblioteka fizike digjitale dhe qasje falas në internet.
- Në segmentin Edukimi kombëtar dhe arsimit premtohet unifikimi i programeve mësimore me Shqipërinë, Kosovën, formimi i institutit të përbashkët, kultivimi i të folurit dhe gjuhës. Planifikohet vënia në veprim e një arsimit të përforcuar në shkollimin e mesëm, për të gjithë ata që do të kalojnë provimin pranues në gjimnaz, ndërsa për gjithë të tjerët regjistrim në shkollat profesionale.
- Më tej, në pjesën e arsimit premtohet arsimit profesional cilësor, rritja e sigurisë në shkolla, përforcimi i cilësisë së universiteteve.

„Gjimnazet për teknologji dhe shkencat digjitale do të formohen ose do të zhvillohen më tej në Shkup, Tetovë dhe Manastir“.

Fragment nga programi zgjedhor Plani 2030 i Koalicionit VLEN

Programi Të pakorruptueshmit në Kuvend i Levicës

Në programin Të pakorruptueshmit në Kuvend ka masa konkrete për rininë në kapitullin I. Puna dhe drejtësia sociale pjesë e posaçme për Rininë.

Në këto masa përfshihen:

- Krijimi i kushteve për sigurimet shëndetësore dhe pensionale për punonjësit e pavarur të moshës deri në 26 vjeç.
oformimi i qendrave kulturore rinore të përdorshme për shumë qëllime në territorin e tërë Republikës,
- Formimi i rrjeteve të veçanta dhe fondeve për mbështetjen e talenteve të rinj nga të gjitha fushat e artit,
- Ndërtimi i institucioneve të specializuara për punë me fëmijë të talentuar nga moshën e hershme,
- Lirime për të a.sh. pako kulturore për të rinjtë deri në moshën 29 vjeçe, lirime për transportin ndërurban për të rinjtë deri në moshën 26 vjeçe,
- Rritja e subvencionimit për prodhimin organik me varietete dhe lloje autoktone për fermerët e rinj,
- Subvencionimi i banesave sociale për të rinjtë deri në moshën 29 vjeçe, si dhe për çiftet e reja të martuara (me ose pa fëmijë).

Politika ndërsektoriale për çështje të lidhura me rininë

Krahas fokusit të politikave rinore në segmentin Koha për Rininë, në Platforma #1198 e VMRO-DPMNE-së janë përfshirë politikat për rininë në shumë kapituj d.m.th. në sektorë institucionalë.

Kjo përmendet që në fjalën hyrëse të liderit të partisë ku qëndron se të rinjtë janë pikë qendrore e programit zgjedhor në të cilin thuhet se më tej janë zhvendosur masat për mbështetjen e pjesëmarrjes rinore në politikë, mbështetjen dhe zhvillimin e sportit, cilësinë e arsimit, bursat dhe mbështetjen e frymës sipërmarrëse.

Në kapitullin I Lufta për standard jetësor cilësor, në pjesën 2 Sektori privat konkurrues parashihet mbështetja e ekosistemit të nismave start up dhe me këtë mbështetja e frymës sipërmarrëse të rinjtë. Në mbështetjen e planifikuar hyjnë zgjidhje të reja ligjore për nxitjen e nismave sipërmarrëse, zgjidhje ligjore për engjëjt e biznesit, si dhe mbështetje përmes sigurimit të hapësirave pa pagesë.

Në pjesën 3 Mbështetja e inovacioneve dhe sektori TIK, janë paraparë më tepër masa për zhvillimin e shkathtësive digjitale të rinjtë, siç janë talenti teknologjik në arsimin e ulët dhe të mesëm (mendimi algoritmik, puna me të dhënat, teknologjitë e ndryshimeve, inteligjenca artificiale dhe inteligjenca artificiale gjenerative, bazat e programimit, puna me përmbajtjet multimediale, siguria onlajn), TI moduli për gjimnazistë që do të sigurojë nivelin e mesëm të arsimimit digjital për çdo rinitar të moshës 18 vjeçe, si dhe 15.000 trajnime të TIK-ut për qytetarët maqedonas. Premtohet themelimi i parkut teknologjik Shkup smart me vende të reja të punës për të rinjtë me shkathtësi të TI-së.

Në pjesën 4 vende produktive pune dhe me pagesë të lartë premtohet mbështetje e fuqishme financiare prej 15 milionë eurosh për tregun e punës.

Në pjesën 5 Plani kombëtar i demografisë premtohet një qasje e re të rinjtë që t'u ofrohen arsim të arritshëm, vende të punës dhe paga të qëndrueshme për të mbuluar harxhimet e jetesës dhe kujdesit të fëmijëve. Në pjesën e njëjtë janë paraparë edhe masat ekonomike për familjet e a.sh. masa Shtëpi për të rinjtë përmes përmirësimit të masës Blini shtëpi për të rinjtë.

Në pjesën 7 Bujqësi dhe ushqim për Maqedoninë në Zhvillimin e mjediseve rurale planifikohen mjete të pakthyeshme për fermerët e rinj – për projekte me biznes-plan të ofruar për nisjen e biznesit agrar dhe mbështetje financiare për çiftet e reja të martuara që do të kthehen në vendbanimet rurale dhe do të nisin biznesin e tyre.

Në kapitullin III Institucionet punojnë sipas ligjeve parashikohet riorganizimi i ministrive, me ç'rast segmenti rinia do të përfshihej në kuadër të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

Në kapitullin IV Sistem funksional për qytetarët në pjesën 1 Do të ketë sistem shëndetësor cilësor premtohet mbështetje domethënëse për mjekët e rinj përmes zhvillimit të Strategjisë shëndetësore kombëtare dhe strategjisë për mjekët e rinj, që do të mundësojë punën e denjë të tyre në sistemin shëndetësor. Specializantët e ri – ardhmëria e shëndetësisë maqedonase planifikohet që të mbështeten përmes dyfishimit të numrit të specializimeve në fushat deficitare dhe planifikimit strategjik të specializimeve. Në kuadër të strategjisë për mjekët e rinj planifikohet të përfshihet përpunimi i planit të karrierës, përcaktimi i kompensimit dinjitoz financiar për specializantët dhe kujdestaritë me pagesë.

Në pjesën 2 Arsimit për ardhmërinë janë ndërmarrë masa të shumta përmes së cilave në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë duhet të ndikohet në zhvillimin e të rinjve në shtet. Në fushën arsimit fillor dhe të mesëm si bazë për sukses janë planifikuar këtë masa: revidimi i planeve dhe programeve mësimore, mësim me një ndërrim dhe qëndrim të vazhduar për çdo nxënës, libër shkollor për çdo nxënës, si dhe revizion të plotë të konceptit për arsimin fillor. Më tej parashihet përforcimi i orientimit profesional të nxënësve, matja e nxënësve në kompanitë përmes punës praktike, kompani reale në shkolla, qendra për nxënës të talentuar, si dhe themelimi i qendrave rajonale për arsim profesional dhe trajnime. Gjithashtu, premtohet edhe përforcimi i mbështetjes socio-emocionale të prindërve dhe të nxënësve dhe përforcimi i sigurisë së nxënësve përmes Programit për parandalimin e dhunës në shkolla dhe për një mjedis shkollor të sigurt. Për arsimin sipëror të rinisë premtohet zhvillimi i punës praktike të studentëve në kompani dhe institucione gjatë studimeve të tyre, përforcimi i programeve për diplomë të dyfishtë në institucionet e arsimit sipëror, të cilat janë mjaft të rëndësishme për pasurimin e dijes dhe shkathtësive dhe sjelljen e programeve ndërkombëtare me universitetet botërore, masa stimuluese për regjistrimin e studentëve në fakultete për shkencat natyrore-matematike, tekniko-teknologjike, bioteknike me lirim nga participimi dhe rritje të bursës mujore. Për arsim gjithëpërfshirës parashikohet avancimi i mëtejshëm përmes mbështetjes së përmirësuar dhe të shtuar të nxënësve me aftësi të kufizuara, ndihmesë arsimore, teknologji ndihmëse, kuadër i trajnuar arsimor dhe mjedis gjithëpërfshirës shkollor. Në lidhje me strukturën arsimore premtohet investim prej 25 milionë eurosh që do të dedikohen për rinovimin dhe rindërtimin e plotë të konvikteve studentore, me qëllim të sigurimit të kushteve të denja për jetesë dhe mësim për studentët.

Në kapitullin V. Patriotizmi që bashkon, në pjesën 1 Prioritetet kombëtare të politikës së jashtme maqedonase parashikohet masa intern.mk me të cilën hapen dyert për praktikën e studentëve në shkencat politike dhe juridike, diplomaci dhe ngjashëm.

Në pjesën 2 Siguria dhe Mbrojtja parashihen masa për përforcimin e sigurisë në shkolla përmes formimit të agjencisë shtetërore për siguri e cila do ta marrë përsipër sigurimin e shkollave, eliminimin dhe parandalimin e dhunës ndërmjet moshatarëve, si edhe masa për punësimin e studentëve më të mirë në MPB dhe në agjencitë e sigurimit.

„Përmes programeve të Agjencisë së punësimit që orientohen në masat për punësimin e të rinjve, krijimin e shkathtësive dhe kualifikimeve, parakualifikimeve dhe rikualifikimeve të kategorive të rrezikuara, trajnimeve për shkathtësitë e nevojshme për tregun e punës, mbështetjen e sipërmarrësisë, si dhe bashkëfinancimin e trajnimeve për shfrytëzimin e teknologjive të reja do të mundësojë hapjen e vendeve të reja të punës dhe punëtorë më produktivë.“

Fragment nga programi zgjedhor Platforma #1198 e VMRO-DPMNE-së.

Në pjesën 3 Kultura shtyllë e shtetit maqedonas parashihet avancimi i mundësive për zhvillimin kulturor të rinisë përmes krijimit të programeve adekuate kulturore dhe kulturore–arsimore për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në drejtim të nxitjes së kreativitetit të tyre. Kultura për fëmijë dhe të rinj do të përfshijë mbështetjen e shtuar të produksionit muzikor, filmik dhe televiziv për fëmijë dhe të rinj në gjuhën maqedonase, si dhe konceptin sistemor për zhvillimin e programeve kulturore–arsimore me qasje për publikun.

Në pjesën 4 Maqedonia destinacion tërheqës turistik parashikohet përmirësimi i arsimit profesional në turizëm përmes avancimit të punës praktike në shkollat e mesme, bashkëpunimi me kompanitë ekonomike, modernizimi dhe përmirësimi i cilësisë së programeve mësimore. Më tej thuhet „do të punojmë në zvogëlimin e hendekut ndërmjet arsimit dhe punëdhënësve në fushën e turizmit“. Gjithashtu, në këtë pjesë parashihen studime të specializuara njëvjeçare për turizëm.

Në pjesën 6 Sporti krenari kombëtare janë përfshirë masa për të rinjtë që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve për veprimtari sportive dhe për mbështetjen e sportistëve. Masat e zhvendosura në fushën Sportistët janë të rëndësishëm për ne përfshijnë sport për çdo fëmijë përmes sigurimit të kushteve adekuate për mbarëvajtjen e edukimit fizik në çdo shkollë fillore dhe të mesme. Përmes programeve për mbështetjen e klubeve sportive planifikohet që të stimulohen sa më tepër fëmijë për t'u kyçur në mënyrë aktive në aktivitetet profesionale sportive. Për fëmijët e talentuar, të cilët vijnë nga familjet që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, shteti duhet të financojë anëtarësi mujore në klubet sportive. Gjithashtu, si një nga masat është edhe vendosja e ligës sportive shkollore.

Në Programin për ardhmëri evropiane 2024 të LSDM–së dhe Koalicionit për ardhmëri evropiane, gjithashtu janë integruar masat rinore dhe politikat përgjatë shumë sektorëve.

Në kapitullin I Energji e re ekonomike për zhvillim dhe standard evropian janë paraparë mjete për përfundimin e kapaciteteve të të rinjve dhe përmirësimin e gjendjes dhe pavarësisë së tyre ekonomike.

Në pjesën Energji e re ekonomike parashikohet masa 200 euro për punësimin e parë për të rinjtë deri në moshën 26 vjeçare si mbështetje stimuluese financiare që do t'u japë mundësi të fillojnë t'i realizojnë ëndrrat e tyre në vendin e tyre. Gjithashtu, parashihen edhe masa për përfundimin e kapitalit njerëzor përmes harmonizimit të arsimit me nevojat e tregut, më tej vendosjen e programeve të reja mësimore përmes së cilave mënyra sipërmarrëse e mendimit do të integrohet në sistemin e gjithmbarshëm arsimor. Segment të veçantë do të paraqesë formimi qendrave sipërmarrëse. Planifikohen bursa për studimet e doktoratës në sferat e specializimit të mençur. Gjithashtu, planifikohet vendosja e programeve digjitale arsimore, siç është promovimi i lëndëve STEM (Science, Technology, Education and Mathematics) dhe masa për nxitjen e sipërmarrësisë përmes lirim të pagesa e tatimit për firmat e sapoformuara nga të rinjtë deri në moshën 29 vjeçare, përderisa qarkullimi i përgjithshëm i nuk tejkalon 4 milionë denarë.

Në pjesën 2 Maqedonia me infrastrukturë evropiane planifikohet masa për ndërtimin e banesave për të rinjtë dhe ata të rinj që formojnë familje. Projekti parashikon ndërtimin e banesave komerciale për të rinjtë deri në moshën 29 vjeçe, në çmimin e blerjes së saj Qeveria do të subvencionojë përqindje të caktuar nga vlera e kostos së banesës. Masa për ndërtimtari të fuqishme me standarde dhe kapital të ri njerëzor parashikon studime pa pagesë në kuotën shtetërore për të gjithë studentët e regjistruar në Fakultetin e Ndërtimtarisë (të gjitha programet studimore) dhe për studentët e regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës.

o Në pjesën 4 Shija e Maqedonisë parashikohen masa për fermerët e rinj deri në moshën 40 vjeçare që nisin biznesin e tyre në bujqësi, grante deri në 10.000 euro dhe rritje të grantit për 50 % nga 10.000 euro në 15.000 euro, duke filluar nga viti 2026. Fermerët e rinj që e marrin përsipër ekonominë agrare të familjes do të marrin grant deri në 20.000 euro, 100 % rritje të subvencioneve për pagesa të drejtpërdrejta në 5 vjetët e parë për fermerët e rinj kur e marrin biznesin dhe regjistrohen në Regjistrin e vetëm të ekonomisë agrare (RVEA). Planifikohet rritje për 40% të bursave studentore për studentët nga lëmia e shkencave bujqësore, pyjore dhe veterinare në institucionet publike të arsimit të lartë në lartësi nga 18.000 denarë në 25.000 denarë për një periudhë nëntë mujore në vit, duke filluar nga viti 2025, dhe punësim të garantuar për të gjithë studentët e diplomuar.

Në kapitullin II Administrimi i mirë – sistem më i mirë dhe i drejtë për të gjithë, me qëllim të sigurimit të institucioneve efikase dhe administratës së motivuar për qytetarë të kënaqur, parashikohet vendosja e masave stimuluese për mbajtjen e studentëve më të mirë të universiteteve tona në sektorin publik, në atë mënyrë që do të garantohet punësimi i të diplomuarve në ministri dhe komuna me shpërblimet e marra, me njohjet ndërkombëtare dhe vendore, me praktikën e realizuar gjatë studimit, me pjesëmarrjen e tyre në konferenca, seminare dhe ngjashëm.

Në kapitullin III Kujdesi për të gjithë, pjesa 1 Më shumë dhe më mirë për të gjithë, planifikohet zgjerimi i mëtejme i masës garanci rinore që tani do të përfshijë 35.000 persona. Për herën e parë parashikohet përdorimi i softuerit për punë rinore, për krijimin e një sistemi për mbështetjen psikosociale të të rinjve dhe promovimin e shëndetit mendor. Masat tjera përfshijnë promovimin e këshillimoreve onlajn, ndjekjen e modeleve të reja të mbështetjes së qytetarëve përmes implementimit të këshillimoreve onlajn për dhënien e mbështetjes psiko-sociale për qytetarët, me fokus të veçantë për viktimat e dhunës në bazë gjinore dhe dhunës familjare, por edhe mbështetjen e rinisë. Më tej planifikohet zhvillimi i qendrave rinore për mbështetje psiko-sociale të fëmijëve, të rinjve dhe prindërve të tyre përmes hapjes së tetë qendrave rajonale këshillëdhënëse për fëmijë dhe të rinjë, promovimi i pikave të sigurta për të rinjtë në çdo qendër ndërkombetale të punës sociale për përmirësimin e qasjes së shërbimeve lidhur me shëndetin mendor të rinisë, si dhe përmes zhvillimit të shërbimeve të bazuara në saje të nevojave të rinisë, për promovimin e rëndësisë së shëndetit mendor të rinisë drejt arritjes së mirëqenies së plotë.

Premtohet një sistem i ri mbështetjeje i ashtuquajtur bonusi shkollor i gushtit me mbështetje financiare vetëm një herë prej 6.000 denarësh si pako për mbështetjen e familjeve për çdo fatos dhe pako për mbështetje të gjimnazistit i cili vijon vitin e parë në shkollën e mesme.

„Rinia është ardhmëria jonë dhe për këtë arsye Qeveria e re e udhëhequr nga LSDM krijon masën për sigurimin e njësive të volitshme banesore për çiftet e reja të martuara.“

Fragment nga programi zgjedhor Programi për ardhmërinë evropiane 2024 i LSDM-së dhe Koalicionit për ardhmëri evropiane

Gjithashtu, parashihet edhe masa për rritjen e shumës së shtesës rinore dhe zhvendosja e kufirit të përfshirjes në masën rritja e përfshirjes së të rinjve nga familjet e rrezikuara me përfshirje në punë dhe rritjen e shumës që e pranojnë prej 3.000 denarë në 5.000 denarë në muaj, përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për shtesën rinore. Përmendet si masë edhe zhvillimi i softuerit „Punë për të rinjtë – E-youth job“ sipas modelit sloven „Stabiliteti ekonomik dhe pavarësia për të rinjtë – çelësi i zhvillimit shoqëror“. Sistemi është platformë elektronike që ndërmjetëson për gjetjen e punës së përkohshme dhe me kohë të pjesshme për gjimnazistë dhe për studentë. Qëllimi është të mundësohet aktivizimi i 65% të rinisë në dy vitet e para nga themelimi i sistemit.

o Në pjesën 2 Standarde evropiane për shëndetësinë maqedonase premtohet avancimi i kushteve për arsimin shëndetësor përmes rritjes së kuotës për studentë në institucionet e arsimit të lartë, konkretisht, dyfishimit të kuotave në Fakultetet e Mjekësisë, në Fakultetet e Stomatologjisë dhe në Fakultetet e Farmacisë. Në atë mënyrë, në një vit do të rritet numri i kuadrit për 100% dhe do të prodhohen kuadro cilësorë. Parashikohet të gjithë studentët të lirohen nga shpenzimet të cilat do t'i paguajë Qeveria nga Buxheti i MASH-it. Të rritet numri i specializimeve vjetore dhe të barazohet statusi i specializantëve mes specializantëve shtetërorë dhe privatë. Për çdo specializant të krijohet vendi i punës në rrjetin shëndetësor, me fokus në fushat mjekësore dhe në qytetet prioritare të vendit. Specializantët duhet t'i realizojnë të gjitha të drejtat gjatë stazhit të tyre, përmes sigurimit të plotë shëndetësor dhe të marrin kompensim themelor mujor fillimisht prej 60.000 denarësh. Si masë domethënëse, planifikohet të zhvillohet Fakulteti i shkencave mjekësore në rajonin jugperëndimor të shtetit pranë Universitetit Sh. Kliment Ohridski në Manastir. Gjithashtu, planifikohet të përpilohet strategjia shtetërore për regjistrimin e studentëve në mjekësi, stomatologji dhe farmaci, si dhe specializime, në përputhje me nevojat e shtetit dhe në përputhje me shpërndarjen e barabartë të institucioneve të arsimit të lartë, për t'u siguruar arsimit të lartë cilësor.

o Në pjesën 3 Arsimit dhe shkathtësi për ardhmëri evropiane politikat kryesore janë: kushte më të mira dhe më të sigurta të nxënësve në shkolla dhe kushte më të mira qëndrimi në konviktet studentore dhe shkollore (nxënës të sigurt, shujtë falas për të gjithë filloristët, sanksione për çdo njërin që bullizon, ekskursion falas edukues, transport publik pa pagesë, TI pajisje dhe teknologji ndihmëse për çdo shkollë, kushte më të mira në konviktet shkollore); bursa për nxënësit në arsimin e mesëm dhe subvencion prej 3.000 denarë për materiale shkollore dhe mjete ndihmëse për çdo nxënës; shujtë e subvencionuar për të gjithë gjimnazistët me shumën 180 denarë në ditë ose 900 denarë në javë; avancimi i punës me nxënës që kanë talent dhe dhunti; mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin fillor dhe të mesëm; nxitjen e interesit të nxënësve për regjistrim në fakultetet pedagogjike. Në pjesën e arsimit të lartë planifikohet, gjithashtu, transport falas për të gjithë studentët, shumë për shujtë studentore më së paku 200 denarë, heqjen e taksës për paraqitjen e provimit, krijimin e kulturës për hulumtime dhe inovacione përmes konceptit – strategjia për „Hulumtim të përgjegjshëm dhe inovacion“; politika të qarta për cilësi më të mirë të arsimit të lartë. Më tej, theksohet zotimi për mbajtjen e studentëve më të mirë dhe angazhimin e të rinjve në institucionet e larta dhe shkencore të vendit.

● Në kapitullin V Maqedoni e sigurt në pjesën 1 Më të fuqishëm me NATO-n parashikohet Masa aktive për nxitjen e të rinjve përmes dhënies së bursave studentëve më të mirë të degëve kritike.

● Në kapitullin IV Cilësi evropiane e jetesës masat janë zhvendosur në pjesën 4 Sport për të gjithë përmes së cilave pritet të stimulohet sistemi sportiv i barabartë, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm i cili do të kontribuojë për të pasur një rini të shëndetshme dhe përmbajtje të cilat do t'i motivojnë të rinjtë. Masivizim të sporteve dhe përmirësim të rezultateve sportive për të gjitha sportet.

● Në kapitullin VI #MK në BE 2030 theksohet rëndësia e Rinisë për #MK në BE2030: hallkë kyçe për realizimin e ardhmërisë evropiane të vendit. Më tej, përmendet masa Rini aktive „ambasadore“ e vendit në mesin e vendeve anëtare të BE-së, me ç'rast planifikohet që të formohet Fondi për mbështetjen e talentëve të rinj – „ambasadorë – MK talentë“ të cilët duhet të jenë drejtuesit e zhvillimit dhe të ardhmës. Gjithashtu planifikohet që të vendoset rrjeti i start –ap ambasadorëve nga qytetarët tanë që jetojnë dhe punojnë në Maqedoninë e Veriut me entuziastë mjaft të profilizuar që jetojnë dhe punojnë në qendrat më të avancuara teknologjike të Evropës dhe botës. Ambasadorët janë të rinjtë që do të shërbejnë si një urë promovimi të kompanive start-ap maqedonase para kompanive potenciale të huaja dhe biznes engjëjve.

Në programin Evropa 2030 të Frontit evropian rinia është përfshirë në disa fusha sektoriale:

Në kapitullin 3 Marrëveshje për konsensus ekonomik, në pjesën 3.1 Ekonomi konkurruese dhe transformim digjital, janë përfshirë masa për Arsim cilësor dhe aftësi pune. Këtu përmendet si masë përforcimi i arsimit dual, qasje në trajnimet profesionale, qasje në programe për arsimin e të rriturve. Më tej, parashikohet vendosja Kornizës evropiane për shkathtësi digjitale në programet kombëtare mësimore, themelimi i shkollave „të mençura“ fillore dhe të mesme me mjete të IT-së dhe infrastrukturë interneti. Është zhvendosur edhe zotimi i përgjithshëm për avancimin e cilësisë së mësimin fillor, të mesëm dhe të lartë përmes reformave në programet mësimore dhe modelet për vlerësimin e procesit arsimor. Paralelisht me këto reforma në arsim do të vendoseshin edhe disa skema të reja për mbështetjen e sipërmarrjeve. Në këtë pjesë janë përfshirë edhe Masa aktive për tregun e punës.

o Në pjesën 3.2 Zhvillimi i qëndrueshëm dhe transformimi i gjelbër në kuadër të masave për Zhvillim rural dhe agrar parashikohet përmes Programit për mbështetje financiare të bujqësisë dhe programit për zhvillim rural të stimulohen fermerët e rinj nën moshën 40 vjeçare.

o Në pjesën 3.3 Infrastrukturë moderne dhe zhvillim të barabartë rajonal, për zhvillim të barabartë parashihet lirimi nga tatimet për të gjitha sipërmarrjet private të krijuara kohë më parë nga individët e rinj deri në moshën 30 vjeçare, programe specifike për nxitjen e punësimit të të rinjve dhe grave përmes trajnimeve, subvencioneve për paga dhe mbështetje për punësim, si dhe programe praktike për rritjen e punësimit të të rinjtë, gratë dhe grupet tjera të rrezikuara. Këto programe janë të orientuara veçanërisht në rajonet më të prekura, si: Rajoni i Pollogut, Rajoni verilindor dhe Rajoni jugperëndimor, ku papunësia është më e lartë. Planifikohet edhe Ligji për sipërmarrësi sociale që të ndihmohen të rinjtë dhe gratë që duan të formojnë sipërmarrje sociale.

Në kuadër të masës Rajone tërheqëse të planifikimit me shërbime të përmirësuara vendore, qasje efektive në tregun e punës, përmes sigurimit të nivelit më të lartë të barazisë gjinore dhe mbrojtje efikase sociale të kategorive më të rrezikuara është paraparë: rritja e Fondit për ndërtimin e banesave sociale në zonat e shpërngulura, përmirësimi i aktivitetit dhe punësimi i të rinjve në tregun e punës, duke siguruar programe dhe masa për zgjerimin e përfshirjes së tyre në punësim dhe arsim, me fokus të të rinjtë që nuk janë të punësuar fare ose që nuk janë të përfshirë në arsim (NEET).

„Institucionalizimi i Garancisë për rininë përmes miratimit të ligjit të posaçëm. Kjo do të sigurojë strukturë të qëndrueshme për mbështetjen e të rinjve në punësim, duke përfshirë programet dhe shërbimet që u ndihmojnë atyre në gjetjen dhe ruajtjen e vendit të punës“.

Fragment nga programi zgjedhor Evropa 2030 i Frontit Evropian

Në Plani 2030 i Koalicionit Vlen ka politika rinore edhe në pjesë tjera të programit si për shembull:

Në kapitullin III Makroekonomia: për qytetarin parashihet përforcimi i zonave të lira ekonomike përmes themelimit të zonave të lira ekonomike shqiptare. Një nga ato zona planifikohet të jetë Zona e lirë ekonomike rinore dedikuar bizneseve rinore në të cilën do të ketë përfitime për start-up-et dhe për sektorin teknologjik.

Në kapitullin V Diaspora dhe kthimi parashihet përgjysmimi i tatimit në fitim dhe zbatimi i sistemit kreditor për ata që janë kthyer nga diaspora dhe të cilët do të hapin biznese, të cilët do të punësojnë të rinjtë dhe gratë. Në kuadër të kapitullit të njëjtë parashikohet zero interes për çiftet e reja bashkëshortore për blerjen e banesave.

Në programin Të pakorruptueshmit në Kuvend në kapitullin I. Puna dhe drejtësia sociale, përveç se në segmentin e veçantë për të rinjtë ka edhe masa tjera që kanë të bëjnë me të rinjtë. Si për shembull:

o Në pjesën Të drejtat e punës parashikohen përfitime për të rinjtë të cilët për herë të parë lidhin një marrëdhënie pune.

o Në pjesën Viktimat e dhunës, lidhur me parandalimin e delikuencës së të miturve planifikohet rindërtimi i sistemit për shkollat e posaçme për riedukimin e fëmijëve problematikë me sjellje të pahijshme dhe të dhunshme.

o Në pjesën Personat me aftësi të kufizuara dhe personat me nevoja të posaçme premtohet punësimi i asistentëve shkollorë, d.m.th. asistentëve arsimorë, të cilët do t'u ndihmojnë në shkollë nxënësve me nevoja të veçanta, nga Ministria e Arsimit, dhe edukim plotësues pa pagesë, bursa universitare për personat me aftësi të kufizuara, mundësia për lëndët zgjedhore në përputhje me afinitetet e personave me aftësi të kufizuara dhe vendosja e arsimit të mesëm pa pagesë për këta persona.

o Në pjesën Mbrojtja e fëmijëve parashikohet Programi kombëtar „Punë për secilin“ me masa për integrimin në procesin e punës personat e rinj pa prindër ose pa përkujdesje prindërore.

Në kapitullin III Sistemi politik dhe administrata, në pjesën Shoqëria informatike dhe transformimi digjital i shërbimeve publike parashihet masa bashkëpunim me firmat e TI-së, të cilat do të ofronin tutorizim profesional për të rinjtë dhe të moshuarit. Risitë nga shërbimet digjitale që janë të rëndësishme për të rinjtë janë vënia në përdorim e E-ditarit dhe E-indeksit, si dhe E-tekstet shkollore për nxënës dhe studentë.

Në kapitullin VII Kultura, turizmi dhe sporti, në pjesën Arti, muzika dhe filmi parashikohet formimi i rrjetit të veçantë të qendrave për mbështetjen e talenteve të reja qysh nga mosha e njomë, nga të gjitha fushat e artit, ndërsa në pjesën Sporti amator luna-parqe, skejt-parqe, parqe ujore, park sportiv – ziplajn dhe kënde lojërash për fëmijë me përmbajtje argëtuese dhe rekreative në disa lokalitete anembanë Maqedonisë, si dhe program shtetëror për ndihmesë sportive – lirim nga anëtarësimi në klube sportive për fëmijët e familjeve të rrezikuara sociale, me qëllim të rritjes së sportit qysh në moshë të hershme për të gjithë.

Në kapitullin VIII Arsimi dhe shkenca parashikohen masa për përmirësimin e standardit të studentit dhe të nxënësit siç janë tekstet shkollore pa pagesë, shujtë pa pagesë, transport publik pa pagesë, lirim gjatë dhënies së provimit të lejes për vozitje dhe pako minimale për aktivitete kulturore dhe sociale. Në pjesën Të drejtat studentore parashikohet arsim i lartë pa pagesë, punësim i garantuar i studentëve me mesatare të lartë, punë e pandërprerë e leximoreve të fakulteteve, ndryshime në sistemin e dhënies së bursave studentore për studim jashtë vendit, ndryshime në përfaqësimin studentor, formimi i klubeve studentore dhe ngjashëm.

Në kapitullin IX Shëndetësia premtohet punësimi i garantuar në shëndetësinë publike të studentëve më të mirë në shkencat medicinare, subvencionimi i drejtë financiar për mjekët e rinj në shëndetësinë parësore, me theks të veçantë për mjekët e fushave deficitare dhe mjediseve rurale, përmirësimi i statusit të specializantëve përmes një sërë masash, të tipit shpallje e rregullt e konkurseve për specializantë, specializimi pa pagesë, rritja e kontributit mujor për specializantët, përmirësimi i mentorimit dhe edukimit gjatë specializimit, sigurimi shëndetësor i specializantëve privatë etj. Gjithashtu, parashikohet edhe masa shërbime stomatologjike bazike pa pagesë për të rinjtë (deri në moshën 21 vjeçare).

Në kapitullin X Bujqësia parashikohet masa për formimin e qendrave edukuese për mbështetje mentorimi të bujqve dhe fermerëve, me theks të veçantë në aftësimin dhe përfshirjen e të rinjve dhe grave, si dhe veçimin e kategorisë së posaçme për subvencionim – bujq të rinj, veçanërisht për: prodhimin e qumështit, zejtarisë, kulturave të reja, eko-fermave dhe eko-turizmit“.

„Ndarje pa pagesë e parcelave tokësore fermerëve të rinj individualë, me qira afatgjatë, me obligimin një përqindje të caktuar të prodhimit të vet t’ia japin vetëqeverisjes lokale – për plotësimin e nevojave të ushqimit në institucionet sociale (p.sh. kuzhinat publike, mensat, kopshtet, shkollat dhe ngjash.).“

Fragment nga programi zgjedhor Të pakorruptueshmit në Kuvend i partisë „Levica“

Në kapitullin XII Siguria publike dhe mbrojtja popullore, në pjesën Policia janë parashikuar masa për risjelljen e shkollës së mesme policore, përkatësisht Qendrën e trajnimit të kadrove nga fusha e sigurisë pranë MPB-së, dhe punësimin e detyrueshëm e të gjithë kadetëve të Qendrës së trajnimit dhe të gjithë krimnologëve të diplomuar të Akademisë policore. Në pjesën Armata premtohet punësimi i detyrueshëm i kadetëve të diplomuar të Akademisë ushtarake – në Ministrinë e Mbrojtjes ose në ARM.

Analiza e gjerë e programeve zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve për zgjedhjet parlamentare tregon se përfshirja e çështjeve lidhur me të rinjtë është e vëllimshme. Politikrat dhe masat për të rinjtë mund t'i gjejmë te çdo subjekt politik dhe pothuajse në çdo fushë të jetës shoqërore të prezantuar në programet zgjedhore.

Pothuajse në të gjitha programet zgjedhore masat e propozuara nuk janë mbështetur me afatet kohore për zbatimin e tyre dhe nuk janë propozuar treguesit përmes së cilëve do të ndiqej zbatimi i tyre. Për shkak të kësaj, është pothuajse e pamundur të vlerësohet vallë masat e propozuara janë të realizueshme dhe çfarë lloji dhe vëllimi të burimeve njerëzore dhe financiare nevojiten për zbatimin e programeve.

Çështjet në lidhje me rininë

Mund të thuhet se programet zgjedhore të subjekteve politike janë në shenjën e mbështetjes së rinisë dhe premtimeve të dhëna për një cilësi më të mirë jetese dhe për një pozitë më të mirë të të rinjve në shtet. Edhe te këto politika dhe masa, edhe te çështjet gjinore, vlen pretendimi se bëhet fjalë për zotime dhe masa që janë mjaft të ngjashme, edhe pse te subjektet e ndryshme politike mund të vërehen masa që janë vënë tashmë në veprim ose janë premtuar në ciklet e mëparshme zgjedhore.

Te çështjet rinore dominojnë premtimet për arsim dhe punësim më të mirë përmes qasjeve tashmë të njohura, siç janë revidimi i programeve mësimore, përforcimi i arsimit profesional, më shumë punë praktike, masa aktive për mbështetjen e punësimit (si trajnime, punë praktike, mbështetje për punëdhënësit që i punësojnë të rinjtë), dhe mbështetje të iniciativave sipërmarrëse. Te disa subjekte politike ka ankand me numra konkretë punësimesh, si dhe shuma konkrete të pagës së të rinjve gjatë punësimit të tyre të parë.

Vend të veçantë në programet zgjedhore zë zhvillimi i shkathtësive digjitale dhe kompetencave të të rinjtë përmes arsimit formal dhe joformal, si dhe mbështetja e iniciativave dhe bizneseve që do të bazohen në ITK-në. Më tej, subjektet politike në këto programe zgjedhore përpiqen të japin përgjigje edhe në problemin e shpërnguljes së të rinjve, gjegjësisht e njohin problemin dhe përpiqen ta zgjidhin përmes masave demografike, masave për përmirësimin e standardit jetësor të çiftet e reja bashkëshortore dhe të të rinjtë në përgjithësi, masave për zhvillimin e karrierës në shtet dhe masave për bashkëpunim me të rinjtë që janë shpërngulur në diasporë dhe që kanë shkathtësi dhe dije përmes të cilave mund të ndihmojnë në përparimin e shtetit.

Pjesë e domosdoshme në programet zgjedhore, si deri më tani, janë masat në fushën e kulturës dhe sportit, mënyra e jetesës së shëndetshme, hapja e qendrave rinore, ndërtimi i terreneve sportive, mbështetja e sportit rinor, etj. Programet zgjedhore edhe këtë herë përfshijnë mbështetjen për bujqit e rinj përmes granteve konkrete dhe si pjesë e programit për zhvillimin rural.

Është interesante se në programet zgjedhore te më shumë subjekte politike kësaj here ndodhen edhe masat konkrete për zgjidhjen e problemit të dhunës në shkolla, bullizmit, mbështetjes për prindërit dhe të rinjtë etj. Përsëri, më të rralla janë masat për përforcimin e pjesëmarrjes rinore në të gjitha nivelet dhe pothuajse janë minimale masat për përforcimin e zbatimit të Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, si dhe masat për punonjësit me të rinjtë dhe mbështetjen e organizatave rinore.

·Është mjaft e rëndësishme të njihen nga afër qytetarët me përfshirjen e çështjeve në lidhje me rininë në kuadër të programeve zgjedhore. Në këtë mënyrë, edhe ata do të mund në mënyrë të pavarur ose me mbështetjen e sektorit qytetar të kërkojnë llogaridhënie më të madhe nga autoritetet e nivelit kombëtar dhe vendor.

·Megjithëse përfshirja e masave që kanë të bëjnë me çështjet rinore mund të jetë më e thelluar dhe më strategjike, megjithatë edhe për këto masa të përfshira me rëndësi është që ato të jenë të operacionalizuara në programe konkrete, që të përfshijnë edhe projeksione financiare edhe buxhet të nevojshëm për realizim, si dhe burime prej nga do të sigurohen mjetet financiare.

·Duke pasur parasysh ekzistimin e një numri të madh prioritetesh të qeverisë dhe tendencën për marginalizimin e çështjeve rinore, është mjaft e rëndësishme të ketë zotim dhe lobim aktiv për këto masa nga sektori qytetar dhe qytetarët për zbatimin e masave përmes monitorimit të vazhdueshëm të punës së qeverisë.

·Është i nevojshëm zhvillimi i dialogut dhe diskutimit publik rreth operacionalizimit të masave për të rinjtë që janë zhvendosur në programet zgjedhore të subjekteve politike. Diskutimi i këtillë publik duhet veçanërisht duhet të ofrojë mundësi për përfaqësim të barabartë të nevojave dhe zgjidhjeve në baza rajonale, etnike dhe gjinore.

·Përfshirja e çështjeve rinore në programet zgjedhore, të cilat konkretisht i referohen bashkësive më të vogla etnike, duhet të jetë më e madhe dhe të përfshijë më shumë masa dhe qasje për trajtimin e nevojave të këtyre bashkësive.

Analiza e programeve zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 2024 të subjekteve politike të cilat tani e përbëjnë Qeverinë (VMRO-DPMNE, Koalicioni „Vlen” dhe Lëvizja Znam) tregoi se në to u përfaqësuan masat dhe politikat që kanë të bëjnë me rininë dhe çështjet rinore. Në këtë rast, tek subjektet politike të cilat tani e përbëjnë Qeverinë, gjegjësisht VMRO-DPMNE dhe Koalicioni „Vlen” u veçuan kapituj të posaçëm kushtuar rinisë, gjersa tek Lëvizja Znam kishte disa masa për rininë të cilat ishin pjesë e fushave tematike të programit të tyre. Kjo tregon se subjektet politike premtuan edhe një qasje më strategjike ndaj çështjeve rinore.

Kjo analizë krahasimore ka për qëllim të hulumtojë në ç’vëllim masat e premtuara në fushën e çështjeve të rinisë, të cilat ishin pjesë e programeve zgjedhore të partive aktualisht në qeveri, janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028. Më konkretisht analiza do të përfshijë paraqitjen e shkurtër të premtimeve në:

- Programin zgjedhor të VMRO-DPMNE-së „Platforma # 1198”.
- Programin zgjedhor të Koalicionit „Vlen” „Plani 2030”.
- Programin zgjedhor të Lëvizjes Znam „Manifest për Maqedoni të denjë”.

Analiza krahasimore e përfshirjes dhe trajtimit në lidhje me rininë

Çështjet që kanë të bëjnë me rininë dominuan si kapituj të veçantë në programet zgjedhore të VMRO-DPMNE-së dhe Koalicionit „Vlen”. Si plotësim, rinia si kategori u përfshi nëpër politikat e ndryshme sektoriale të këtyre subjekteve politike dhe e përfshirë pjesërisht në programin zgjedhor të Lëvizjes Znam. Kështu, politikat për rininë mund të haseshin në fushat tematike arsimit dhe punësimi, bujqësia, si dhe në transformimin digjital të TIK-ut.

Zotimet dhe masat nga platforma #1198 – gjetjet kryesore Kapitulli VI. të drejtat dhe liritë – fokus programor koha e rinisë

Në Platformën # 1198 të VMRO-DPMNE-së fokusi i çështjeve rinore ishte vënë në kapitullin VI. Të drejtat dhe liritë, segment programor Koha e rinisë. Në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 sërish këto çështje janë në kuadër të kapitullit të njëjtë, ndërsa segmenti programor është riemërtuar në Rinia në fokus.

Masat e parapara për rininë në Platformën #1198 në këtë kapitull janë përmbajtur në përgjithësi. Dhe përderisa në programin zgjedhor janë shënuar edhe treguesit sasiorë për investimet te rinia (si për shembull, shuma e bursave studentore, numri i bujqve të rinj të cilët do të përkrahen, shuma për mjetet që do të investoheshin në mbështetjen e iniciativave sipërmarrëse dhe ngj.), në Programin e punës së Qeverisë 2024– 2028 te pjesa më e madhe e masave mungojnë treguesit sasiorë që i bënë masat e tilla jospecifike dhe të vështira për matje d.m.th. vështirësohet ndjekja e realizimit dhe suksesit të këtyre mjeteve.

Në Platformën #1198 ishte premtuar në mënyrë të veçantë Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë që u realizua tanimë. Por, edhe pse përmirësimi i pjesëmarrjes rinore është shënuar si një nga qëllimet e Qeverisë në kuadër të segmentit programor Rinia në fokus, nuk hasen mjetet se si do të përmirësohet pjesëmarrja rinore, as edhe masat për hapjen eqendrave rinore në qytete.

Platforma # 1198 (premtime zgjedhore)

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 (fragmente)

Masat ekonomike për rininë siç janë: 70.000 të rinj të sapopunësuar, lirimi nga tatimi i të ardhurave personale për personat e rinj deri në moshën 29 vjeçe, ofertë e garantuar për punë për 500 studentët më të mirë, punë me honorar për studentët, 5.000 trajnime njëvjeçare për të rinjtë e fushës së TIK-ut, si dhe certifikimi i TIK – profesionistëve, dhe 5 milionë euro për iniciativa sipërmarrëse për të rinjtë.

Masa:

- Programi për 500 studentët me sukses të lartë akademik të studimeve deridiplomike në universitetet publike çdo vit të marrin ofertë për punë në sektorin privat dhe publik;
- Ndryshime ligjore për krijimin e mundësisë që çdo student të punojë me orar të shkurtuar pune pa e humbur statusin e studentit;
- Deri në 5.000 trajnime njëvjeçare për shkathtësi të avancuara digjitale në përputhje me nevojat e kompanive vendore të TIK-ut;
- Bashkëfinancimi për certifikimin ndërkombëtar të profesionistëve të rinj të TIK-ut me qëllim të rritjes së produktivitetit të punonjësve;
- Mjete financiare për iniciativat sipërmarrëse të rinisë si program gjithëpërfshirës për mbështetjen e punësimit të rinisë;
- Shërbime këshillëdhënëse për rininë që do të nisin biznesin në fushën e legjislacionit, financave dhe tatimeve, punës administrative, mjeteve të TI-së, marketingut dhe programe tjera adekuate për mbështetje gjatë nisjes së biznesit personal.

Nxitja e punësimit në profesionet e reja, parashihet lidhja digjitale me botën, qendra novatore digjitale, mbështetje të voluntarizmit rinor në institucionet publike, e – vauçerë për trajnime plotësuese dhe arsimit joformal. Një masë e posaçme orientohet kah bujqit e rinj deri në moshën 40 vjeçare me ç ‘rast parashikohet mbështetje për 5.000 bujq të rinj.

Masat:

- Qeveria do ta mbështesë formimin e qendrave novatore digjitale, qendrave rinore novatore me burime arsimore dhe teknike dhe hapësirë pune.
- Bashkëfinancimi i trajnimeve përmes sistemit të vauçerëve, të platformave të njohura onlajn për edukimin e studentëve të talentuar;
- Institucionet publike do të jenë të hapura për voluntarizëm dhe punë praktike;
- Mbështetje financiare fillestare e zmadhuar për të rinjtë të cilët do të fillojnë të merren me bujqësi.

Standardi rinor, parashikohet aplikacioni celular përmes së cilit të gjithë të rinjtë do të kenë mundësi të shfrytëzojnë lirime për hyrje në teatro, muze, institucione nga fusha e kulturës, transportin publik (të autobusëve dhe hekurudhor), gara sportive dhe ngjarje tjera, si dhe masa e veçantë internet falas për të rinjtë e të gjitha konvikteve studentore dhe shkollore, biblioteka, leximore, qendra rinore dhe fakultete, sheshe dhe pika të tjera urbane.

Masa:

- Në të gjitha konviktet studentore dhe shkollore, bibliotekat, leximoret, qendrat rinore dhe fakultetet do të sigurohet qasje në internet falas.

Standardi rinor, parashikohet aplikacioni celular përmes së cilit të gjithë të rinjtë do të kenë mundësi të shfrytëzojnë lirime për hyrje në teatro, muze, institucione nga fusha e kulturës, transportin publik (të autobusëve dhe hekurudhor), gara sportive dhe ngjarje tjera, si dhe masa e veçantë internet falas për të rinjtë e të gjitha konvikteve studentore dhe shkollore, biblioteka, leximore, qendra rinore dhe fakultete, sheshe dhe pika të tjera urbane.

Masa:

- Qeveria do të punojë në rinovimin gjithëpërfshirës të konvikteve studentore dhe shkollore në shtet, me çka do të mundësojë përmirësimin e kushteve të përgjithshme për qëndrim, si deh ngritjen e standardit studentor.
- Do të rriten mjetet që përcaktohen për bursa për studentë dhe gjimnazistë, ndërsa përmes digjitalizimit të procesit të aplikimit do të pamundësohet korrupsioni.
- Për profesionet deficitare dhe me pagesë të lartë, do të ofrohen bursa të plota studimi, participimi për studime do të zvogëlohet për të gjithë studentët deri në moshën 25 vjeçare, të cilët janë prindër.
-
- Do të sigurohen bursa për studentët që do të arrijnë rezultate në olimpiadën botërore, konkursin ndërkombëtar, shtetëror të dijes në lëndë të ndryshme.

Organizimi rinor dhe prezantimi, në kuadër të riorganizimit ekzistues të ministrive premtohet Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe hapja e qendrave rinore në disa qytete.

Masa:

- Është realizuar masa Ministri e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Nuk ka masa tjera.

Politikat ndërsektoriale rinore

Nga politikat ndërsektoriale rinore në Platformën #1198 të VMRO-DPMNE-së që u zhvendosën në Kapitullin I. Lufta për standard cilësor jetësor (në Programin e punës së Qeverisë emërtohet si Standardi cilësor jetësor – cikël i ri i rritjes ekonomike) pothuajse të gjitha masat janë ruajtur, edhe pse disa prej tyre në formë të modifikuar. Kështu, për shembull, mungojnë treguesit sasiorë të disa nga masat në pjesën Vende produktive pune dhe me pagesë të lartë, d.m.th. treguesit për numrin e trajnimeve që do të financohen. Gjithashtu, në programin zgjedhor pjesa më e madhe e masave për të rinjtë në suaza të sektorëve të ndryshëm u veçuan dhe u shënuan përmes nëntitujve, ndërsa tani në kuadër të Programit të punës së Qeverisë 2024–2028 janë anashkaluar nëntitujt, me ç’gjë vështirësohet identifikimi i këtyre masave me grupin e të rinjve.

Disa masa kanë ndryshuar cilësisht, si për shembull masa për themelimin e parkut teknologjik në pjesën Mbështetja e inovacioneve në sektorin e TIK-ut, e cila tani quhet përgatitja e një studimi dhe projekti zhvillimor për një park multifunksional teknologjiko-inovativ.

Tabelë Krahasimtare 4- Krahasimi i Platformës #1198, politikat multisektoriale rinore me Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028, Kapitulli I. Standard cilësor jetësor – cikël i ri i rritjes ekonomike

Platforma # 1198 (premtime zgjedhore)

Në kapitullin I Lufta për standard cilësor jetësor, në pjesën 2 Sektori konkurrues privat, parashikohet mbështetja e ekosistemit e iniciativave startup dhe me këtë mbështetje frymës sipërmarrëse tek të rinjtë. Në mbështetjen e planifikuar hyjnë zgjidhje të reja ligjore për nxitjen e iniciativave sipërmarrëse, zgjidhje ligjore për engjëjt e biznesit, si dhe mbështetje përmes sigurimit të hapësirave pa pagesë.

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 (fragmente)

Mbështetje për sektorin konkurrues privat

Zotim:

Fryma sipërmarrëse e rinisë dhe personave me përvojë që kanë ide të reja për fillimin e biznesit duhet mbështetur, sepse krijon potencial për rritje ekonomike.

Masa:

- Ndryshime në rregulloren ligjore në drejtim të nxitjes dhe mbështetjes së iniciativave sipërmarrëse;
- Do të përqaset drejt promovimit, revidimit dhe sjelljes së rregullativës ligjore për kapital të rrezikshëm formal (venture capital) dhe financim grupor (crowdfunding), me qëllim që të shtohet konkurrenca dhe qasja në financimin e startap kompanive;
- Hapësirat shtetërore që nuk janë në përdorim do të shndërrohen në hapësira afariste të cilat për një kompensim minimal do të mund t'i shfrytëzojnë startap firmat

Në pjesën 4 Vende produktive pune dhe me pagesë të lartë premtohet mbështetje e fuqishme financiare prej 150 milionë eurosh për tregun e punës.

Vende produktive pune dhe me pagesë të lartë

Masa:

- Përmes programeve të Agjencisë së Punësimit të orientuara në masat për punësimin e të rinjve, ndërtimin e shkathtësive dhe kualifikimeve, parakualifikimeve dhe rikualifikimeve të kategorive të rrezikuara, trajnimeve për shkathtësi të nevojshme për tregun e punës, mbështetjen e sipërmarrësisë, si dhe bashkëfinancimin e trajnimeve për shfrytëzimin e teknologjive të reja do të sigurojmë buxhet prej 150 milionë eurosh.

Në pjesën 5 Plani kombëtar për demografi parashikohet një qasje e re të rinjtë që t'u ofrohet arsim i arritshëm, vende të qëndrueshme pune, dhe paga të cilat do të mund t'ua mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe rritjes së fëmijëve. Në pjesën e njëjtë janë paraparë edhe masa ekonomike për familjet d.m.th. masa Shtëpi për të rinjtë përmes përmirësimit të masës Bli shtëpi për të rinjtë.

Plani kombëtar për demografi

Zotimi:

-Do të miratojmë qasje të re ndaj rinitë, që do t'u mundësojë arsim të arritshëm, standard të denjë jetësor dhe dinjitet njerëzor me qëllim të zvogëlimit të numrit të atyre që janë të detyruar ta lëshojnë Maqedoninë. Një nga kushtet më të rëndësishme për përmirësimin e pamjes demografike të Maqedonisë është stabiliteti dhe siguria e vendeve të punës dhe mundësitë e hapura për afarizëm, veçanërisht për personat e rinj, me të ardhura që mund t'i kënaqin harxhimet e shportës mesatare të shpenzimit dhe shpenzimet për rritjen e fëmijëve.

Masa:

Qeveria do ta rivendosë dhe do ta përmirësojë masën „Bli shtëpi për të rinjtë“, përmes:

-pagesën e subvencioneve me këst mujor për ndërtimin e shtëpisë ose pagesën e subvencioneve për pjesëmarrjen fillestare gjatë marrjes së kredisë për ndërtimin e shtëpisë;

-për çiftet e reja që do të shpërngulen në fshat, do të përpilohet programi me të cilin do të mundësojmë mbështetje

-financiare vetëm një herë për blerjen, ndërtimin ose zgjerimin e shtëpisë.;

-Parashikojmë shitjen e tokës shtetërore të pandërtuar me çmim preferencial për metër katror, si dhe disa lloje projektsh pa pagesë të ndërtimit të shtëpive, të cilat do të ulin më tej kostot familjare dhe do të mbështesin rinovimin me efikasitet energjetik të shtëpive të të rinjve.

Në pjesën 5 Plani kombëtar për demografi parashikohet një qasje e re të rinjtë që t'u ofrohet arsim i arritshëm, vende të qëndrueshme pune, dhe paga të cilat do të mund t'ua mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe rritjes së fëmijëve. Në pjesën e njëjtë janë paraparë edhe masa ekonomike për familjet d.m.th. masa Shtëpi për të rinjtë përmes përmirësimit të masës Bli shtëpi për të rinjtë.

Bujqësi e zhvilluar

Masa:

- mjete të pakthyeshme për bujqit e rinj.
- mbështetje financiare për çiftet e reja martesore të cilat do të kthehen në zonat rurale dhe do të nisin biznesin.

Nga politikat ndërsektoriale rinore në Platformën #1198 të VMRO-DPMNE-së të cilat u zhvendosën në Kapitullin IV. Sistemi funksional për qytetarët (në programin e punës së Qeverisë emërtohet si Sistemi institucional funksional) pothuajse të gjitha masat janë ruajtur, edhe pse disa prej tyre në formë të ndryshuar. Si për shembull, në pjesën tematike të shëndetësisë mungojnë specifikat rreth mbështetjes së specializantëve të rinj.

Masat në pjesën tematike Arsimit për të ardhmen të parapara me Platformën #1198 në përgjithësi janë ruajtur, megjithëse tek disa masa mungojnë treguesit specifikë sasiorë, si për shembull shuma e investimit për rinovimin e konvikteve shkollore dhe studentore.

Tabela Krahasuese 5- Krahasimi i platformës #1198, politikat ndërsektoriale rinore me Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028, Kapitulli IV. Sistem funksional institucional

Platforma # 1198 (premtime zgjedhore)

Në pjesën 1 Do të ketë sistem shëndetësor cilësor premtohet mbështetja domethënëse e mjekëve të rinj përmes zhvillimit të Strategjisë shëndetësore kombëtare dhe strategjisë për mjekët e rinj e cila do të mundësojë punën e tyre të denjë në sistemin shëndetësor. Specializantët e rinj – ardhmëria e shëndetësisë maqedonase planifikohet të mbështetet përmes rritjes së dyfishtë të numrit të specializimeve nga fushat deficitare, planifikimi strategjik i specializimeve. Në kuadër të strategjisë për mjekët e rinj planifikohet të përfshihet përpilimi i planit të karrierës, përcaktimi i kompensimit të denjë financiar të specializantëve dhe kujdestaria e paguar.

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 (fragmente)

Sistem shëndetësor cilësor

Masa:

- Qeveria do të përgatisë dhe do t'i propozojë Kuvendit një Strategji kombëtare shëndetësore dhe një Strategji për mjekët e rinj, e cila do të parashikojnë metodologji, rrugë dhe mënyra për të mbështetur mjekët e rinj dhe për të mundësuar punën e tyre të denjë në sistemin shëndetësor.
- Në kuadër të mundësive ekonomike të shtetit, do të hartohet një plan për punësimin gradual dhe të drejtë për të gjithë të punësuarit në institucionet shëndetësore që punojnë prej vitesh pa marrëdhënie të rregulluar pune, kuadrit mjekësor në profesionet deficitare dhe rritjes së numrit të specializimeve për specialistët e rinj të fushave deficitare.

Në pjesën 2 Arsimit për rininë, në fushën arsimit fillor dhe të mesëm, si bazë të suksesit janë planifikuar masat, siç janë: revidimi i plan-programeve mësimore, mësimi me një ndërrim dhe qëndrimi i vazhduar për çdo nxënës, teksti shkollor për çdo nxënës, si dhe revidimi i plotë i konceptit të arsimit fillor. Më tej, parashikohet përforcimi i orientimit profesional të nxënësve, matja e studentëve në kompani përmes punës praktike, kompanitë reale në shkollë, qendrat për nxënës të talentuar, si dhe themelimi i qendrave rajonale për arsim dhe aftësim profesional. Gjithashtu, premtohet edhe përforcimi i mbështetjes socio-emocionale të prindërve dhe nxënësve dhe përforcimi i sigurisë së nxënësve përmes Programit të veçantë për parandalimin e dhunës në shkollë dhe mjedisit të sigurt shkollor.

Arsim për ardhmërinë

Masa:

- Do të punohet në revizionin gjithëpërfshirës të Konceptit për arsimin fillor.
- Qeveria vazhdimisht do të krijojë kushte infrastrukturore për mësim me një ndërrim në shkollë dhe qëndrim të vazhduar (mësim gjithëditor), si dhe sigurimi i teksteve shkollore për çdo nxënës për çdo lëndë në arsimin fillor dhe të mesëm, duke filluar nga viti shkollor 2025/2026. Për vitin shkollor 2024/2025, Qeveria merr përsipër që tekstet e përgatitura t'ua dorëzojë nxënësve me kohë.
- Orientimi profesional dhe këshillimi i karrierës në arsimin fillor do t'u ofrojë nxënësve dhe prindërve informacione përkatëse për mundësitë dhe tendencat e ndryshme të karrierës në tregun e punës. Me synimin për të nxitur frymën sipërmarrëse të nxënësit dhe lehtësimin e kalimit nga shkollë në punësim/vetëpunësim ose në arsimim të mëtejshëm, do të mbështesim hapjen e kompanive reale në shkollat e mesme. Në shkollat e mesme vend të rëndësishëm do të zënë qendrat moderne të karrierës të cilat në mënyrë të mirëfilltë dhe profesionale do t'i udhëzojnë nxënësit.
- Qeveria në periudhën 2025-2028 do të mundësojë zbatimin pilot të konceptit STEM në sistemin arsimor, sipas kërkesës së prindërve dhe nxënësve, në një numër të caktuar shkollash fillore dhe të mesme, si dhe në fakultete. Parashikojmë edhe formimin e qendrave të posaçme për mbështetjen e punës me nxënës të talentuar.
- Programe për parandalimin e dhunës në shkollë dhe për një mjedis të sigurt shkollor. Programet e parandalimit të dhunës do të nxisin zhvillimin e inteligjencës emocionale, ndjeshmërinë, mbështetjen e shëndetit mendor të nxënësve, komunikimin efektiv dhe mënyrat e parandalimit të ngatërresave, të keqkuptimeve dhe të dhunës moshatare.

<p>Për arsimin e lartë të të rinjve premtohet zhvillimi i punës praktike të studentëve në kompani dhe institucione gjatë studimeve të tyre, përforsimi i programeve për diplomë të dyfishtë në institucionet e arsimit të lartë, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për pasurimin e dijes dhe shkathtësive dhe sjelljen e programeve ndërkombëtare me universitetet botërore, premtohen masa stimuluese për regjistrimin e studentëve në fakultetet e shkencave matematiko-natyrore, tekniko-teknologjike, bioteknike me lirim nga participimi dhe me rritjen e bursës mujore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i punës praktike të studentëve në kompani dhe institucione gjatë studimeve të tyre; • Përforsimi i programeve për diplomë të dyfishtë në institucionet e arsimit të lartë; • Masa stimuluese për regjistrimin e studentëve në fakultetet e shkencave matematiko-natyrore, tekniko-teknologjike, bioteknike me lirim nga participimi dhe me rritjen e bursës mujore.
<p>Për arsimin gjithëpërfshirës parashihet avancimi i mëtejshëm përmes mbështetjes së përmirësuar dhe të shtuar të nxënësve me aftësi të kufizuara, ndihmesë arsimore, teknologji ndihmëse, kuadër i trajnuar arsimor dhe mjedis gjithëpërfshirës shkollor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Do ta avancojmë arsimin gjithëpërfshirës përmes mbështetjes së përmirësuar dhe të shtuar të nxënësve me aftësi të kufizuara, ndihmesë arsimore, teknologji ndihmëse, kuadër i trajnuar arsimor dhe mjedis gjithëpërfshirës shkollor.
<p>Në lidhje me infrastrukturën arsimore premtohet investimi prej 25 milionë eurosh që do të dedikohen për rinovimin dhe rindërtimin e plotë të konvikteve studentore, me qëllim të sigurimit të kushteve të denja të jetesës dhe mësimi të studentëve.</p>	<p>Një nga synimet e Qeverisë është përmirësimi gjithëpërfshirës i infrastrukturës arsimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Masa: • Do të investohen mjete të dedikuara për rinovimin dhe rindërtimin e plotë të konvikteve studentore, me qëllim të sigurimit të kushteve të denja të jetesës dhe mësimi të studentëve.

Nga politikat ndërsektoriale rinore në Platformën #1198 të VMRO-DPMNE-së të cilat u zhvendosën në Kapitullin V. Patriotizmi që bashkon (në Programin e punës së Qeverisë emërtohet si Prioritetet kombëtare) masa intern/mk nuk është përfshirë fare.

Një pjesë e masave në fushën e Mbrojtjes dhe sigurisë, Kultura shtyllë e shtetit dhe Sporti krenari kombëtare të cilat u parapanë me Platformën #1198 nuk janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 (shih tabelën 6).

Tabela Krahasimtare 6- Krahasimi i Platformës #1198, politikat ndërsektoriale rinore me Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028, Kapitulli V. Prioritetet kombëtare

Platforma # 1198 (premtime zgjedhore)

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 (fragmente)

Në kapitullin V. Patriotizmi që bashkon, në pjesën 1 Prioritetet kombëtare të politikës së jashtme maqedonase parashihet masa intern.mk me të cilat hapen dyert për praktikën e studentëve të shkencave politike dhe juridike, diplomacisë e ngj.

Prioritetet në politikën e jashtme

- Nuk ka masa

Në pjesën 2 Siguria dhe mbrojtja parashihen masa për përforsimin e sigurisë në shkolla përmes formimit të agjencisë shtetërore për siguri e cila do të marrë përsipër sigurinë e shkollave, eliminimin dhe parandalimin e dhunës moshatare, si dhe masa për punësimin e studentëve më të mirë në MPB dhe në agjencitë e sigurisë.

Siguria dhe mbrojtja

Masa për agjencinë shtetërore për sigurinë e shkollave është përfshirë në kapitullin IV. Sistem funksional institucional.

- Nuk ka masa tjera.

Në pjesën Kultura shtyllë e shtetit maqedonas parashihet avancimi i mundësive për zhvillimin kulturor të rinisë përmes krijimit të programeve adekuate kulturore dhe kulturore-arsimore dhe për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në drejtim të nxitjes së kreativitetit të tyre. Kultura për fëmijët dhe të rinjtë do të përfshijë një mbështetje të rritur të produksionit muzikor, filmik dhe televiziv për fëmijët dhe të rinjtë në gjuhën maqedonase, si dhe konceptin sistematik për zhvillimin e programeve kulturo-arsimore të afrueshme për publikun.

Kultura shtyllë e shtetit

Masa:

- Krijimi i programeve adekuate kulturore dhe kulturore-arsimore dhe për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në drejtim të nxitjes së kreativitetit të tyre;
- Do të rrisim në mënyrë domethënëse mbështetjen e produksionit muzikor, filmik dhe televiziv për fëmijët dhe të rinjtë në gjuhën maqedonase.

Në pjesën 4 Maqedonia destinacion tërheqës turistik parashikohet përmirësimi i arsimit profesional në turizëm përmes avancimit të punës praktike në shkollat e mesme, bashkëpunimi me kompanitë ekonomike, modernizimi dhe përmirësimi i cilësisë së programeve mësimore. Më tej thuhet „do të punojmë në zvogëlimin e hendekut ndërmjet arsimit dhe punëdhënësve në fushën e turizmit“. Gjithashtu, në këtë pjesë parashihen studime të specializuara njëvjeçare për turizëm.

Turizëm i zhvilluar

Masa:

- Qeveria do të punojë në përmirësimin e arsimit profesional në turizëm, përmes punës praktike në shkollat e mesme, bashkëpunimit me kompanitë ekonomike, modernizimit dhe përmirësimin e cilësisë së programeve mësimore. Me qëllim të ngritjes së interesit për degët specifike shkencore, si dhe pasurimit të kuadrit i cili do të merret me turizëm, do të nxisim krijimin e grupit të specializuar studimor për punë në fushën e kulturës për qëllime turistike.

Në pjesën 6 Sporti krenari kombëtare janë përfshirë masat për të rinjtë që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve për sport dhe mbështetjen e sportistëve. Masat e zhvendosura në fushën Sportistët janë të rëndësishëm për ne përfshijnë sport për çdo fëmijë përmes sigurimit të kushteve adekuate për mbarëvajtjen e edukimit fizik në çdo shkollë fillore dhe të mesme. Përmes programeve për mbështetjen e klubeve sportive planifikohet që të stimulohen sa më tepër fëmijë për t'u kyçur në mënyrë aktive në aktivitetet profesionale sportive. Për fëmijët e talentuar, të cilët vijnë nga familjet që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, shteti duhet të financojë anëtarësi mujore në klubet sportive. Gjithashtu, si një nga masat është edhe vendosja e ligës sportive shkollore.

Sporti krenari kombëtare

Masa:

- Qeveria do të sigurojë kushte adekuate për mbarëvajtjen e edukimit fizik në çdo shkollë fillore dhe të mesme që do të kontribuojë për një zhvillim më të mirë psikofizik të fëmijët.
- Si plotësim, Përmes programeve për mbështetjen e klubeve sportive planifikohet që të stimulohen sa më tepër fëmijë për t'u kyçur në mënyrë aktive në aktivitetet profesionale sportive.

Zotimet dhe masat nga Plani 2030 – gjetjet kryesore **Kapitulli VI. rinia, arsimi dhe edukimi**

Në programin Plani 2030 i koalicionit Vlen fokusi i çështjeve rinore ishte vënë në kapitullin e veçantë VI. Rinia, arsimi dhe edukimi.

Një pjesë e masave të kapitullit VI. në Plani 2030 në formë të njëjtë apo të ngjashme janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028, ndërsa këtë janë ato masa të cilat përgjithësisht përputhen me masat e parapara në Platformën #1198.

Masat që kanë të bëjnë me arsimin, siç janë: përforcimi i arsimit të mesëm, unifikimi i programeve mësimore me Kosovën dhe Shqipërinë, formimi i institutit të përbashkët për kultivimin e të folurit dhe gjuhës, nuk janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024–2028.

Tabela Krahasimore Tabela 7– Krahasimi i Planit 2030, fokus politikat rinore nga Kapitulli VI.

Rinia, arsimi dhe edukimi me Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028, segmenti programor Rinia në fokus.

Plani 2030 (premtime zgjedhore)

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 (fragmente)

Në segmentin Fëmijët dhe të rinjtë – lojë, sport dhe kulturë premtohet ndërtimi i 200 terreneve sportive tek vendbanimet shqiptare, 5 qendra kulturore dhe mbështetja e sportistëve elitare.

Masat për ndërtimin e infrastrukturës sportive janë paraparë në pjesën Sporti krenari kombëtare, por nuk ka masa për vendbanimet ku graviton komuniteti etnik shqiptar.

Parashihet që shkollat të jenë qendra komunitare të pajisura me biblioteka fizike digjitale dhe qasje falas në internet.

Masa e këtillë është e paraparë në politikat specifike rinore në pjesën Rinia në fokus.

Masa:

- Në të gjitha konviktet studentore dhe shkollore, bibliotekat, leximoret, qendrat rinore dhe fakultetet do të sigurohet qasje në internetin pa pagesë

Në segmentin Edukimi kombëtar dhe arsimit premtohet unifikimi i programeve mësimore me Shqipërinë dhe Kosovën, formimi i institutit të përbashkët, kultivimi i të folurit dhe gjuhës. Planifikohet vënia në veprim e një arsimit të përforcuar në shkollimin e mesëm, për të gjithë ata që do të kalojnë provimin pranues në gjimnaz, ndërsa për gjithë të tjerët regjistrim në shkollat profesionale.

Masat e përfshira në pjesën Arsimit për ardhmërinë:

- Programe për parandalimin e dhunës në shkolla dhe për një mjedis të sigurt shkolle;
- Orientimi profesional dhe këshillimi i karrierës në arsimin fillor do t'u ofrojë nxënësve dhe prindërve informacione përkatëse për mundësitë dhe tendencat e ndryshme të karrierës në tregun e punës. Me synimin për të nxitur frymën sipërmarrëse të nxënësit dhe lehtësimin e kalimit nga shkolla në punësim/vetëpunësim ose në arsimim të mëtejshëm, do të mbështesim hapjen e kompanive reale në shkollat e mesme. Në shkollat e mesme vend të rëndësishëm do të zënë qendrat moderne të karrierës të cilat në mënyrë të mirëfilltë dhe profesionale do t'i udhëzojnë nxënësit.

Më tej, në pjesën e arsimit premtohet arsimit profesional cilësor, rritja e sigurisë në shkolla, përforcimi i cilësisë së universiteteve.

Politika ndërsektoriale për çështje të lidhura me rininë

Politikat ndërsektoriale në Planin 2030 të Koalicionit Vlen ishin këto:

- Zona e lirë ekonomike për të rinjtë që u dedikohet bizneseve rinore në të cilën do të ketë shumë dobi për start up-et dhe për sektorin e teknologjisë.
- Përgjysmimi i tatimit në fitim dhe zbatimi sistemit të kreditimit për ata që janë kthyer nga diaspora dhe të cilët do të hapin biznese, të cilët do të punësojnë të rinj dhe gra.
- Interes zero për çiftet e reja bashkëshortore për blerje të banesave.

Zona e lirë ekonomike për të rinjtë dhe përgjysmimi i tatimit në fitim të bizneseve që do të punësojnë të rinj dhe gra nuk janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028.

Lidhur me masën për lirimin nga kamata të çifteve të reja bashkëshortore të cilët kanë blerë banesë, është një masë e ngjashme dhe gjithëpërfshirëse për të rinjtë e quajtur Bli shtëpi për të rinjtë.

Zotimet dhe masat e manifestit për Maqedoni të denjë – gjetjet kryesore

Në Manifestin për Maqedoni të denjë u përfshinë masat e mëposhtme specifike për rininë:

- Kredi afatgjatë për kompanitë e sapoformuara nga të rinjtë, interesi i të cilave do të subvencionohet nga shteti.
- Për studentët më të mirë parashikojmë bursa në shumë prej 500 euro në muaj.
- Punësim i siguar i 200 studentëve më të mirë në institucionet shkencore dhe në institucionet e sistemit.

Mund të thuhet se këto masa përgjithësisht janë përfshirë edhe në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 në pjesët Rinia në fokus, Arsimi për ardhmërinë dhe Vende produktive pune me pagesë të lartë. Masat kanë formë të ndryshuar, por në përgjithësi përkohet me qëllimin për të cilin janë propozuar edhe në Manifestin për Maqedoni të denjë, gjegjësisht mbështetja e iniciativave star-up, mbështetja e studentëve dhe mbështetja e punësimit të studentëve më të mirë. Në kuadër të masave, në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 në të cilin janë përfshirë edhe këto masa specifike të Manifestit për Maqedoni të denjë, nuk ka tregues konkretë sasiore.

Përfundime të përgjithshme

Formati në të cilin është përgatitur Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 bazohet në paraqitjen e zotimeve, aktiviteteve dhe masave, synimeve jomjaftueshëm të saktësuar dhe të qarta dhe pranisë së pjesshme të treguesve sasiorë dhe aq më pak të atyre cilësorë. Gjithashtu, në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 nuk veçohen nëntitujt dhe temat siç ishte rasti në programet zgjedhore, gjë që e vështirëson më tej ndjekjen e përfshirjes së disa masave, si dhe përcaktimin për cilat grupe kanë të bëjnë masat e këtilla. Në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 mungonte korniza kohore e realizimit të masave të posaçme, gjë që e vështirëson më tej ndjekjen e realizimit të masave me interes për këtë analizë.

Formati i këtillë e pamundëson opinionin të dijë se cilat janë qëllimet konkrete të cilat duhet të përmbushen në mandatin katërvjeçar të Qeverisë, dhe çfarë rezultatesh priten, gjegjësisht çfarë efekti duhet të japin masat e parapara.

Në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 mungojnë një pjesë e treguesve sasiorë të cilët u premtuan në programin zgjedhor të VMRO-DPMNE-së „Platforma #1198”. Kjo e bën edhe më të vështirë monitorimin e përmbushjes zgjedhore.

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 është përgatitur kryesisht në bazë të „Platformës #1198”, ndërsa masat për rininë dhe masat gjinore të cilat u përfshinë në programet e subjekteve tjera politike të cilat tani janë pjesë e Qeverisë, nuk janë trajtuar veçmas, as janë të integruara në mënyrë specifike, gjegjësisht janë përfshirë masat të cilat edhe ashtu ishin planifikuar në Platformën #1198.

Çështjet lidhur me rininë

Sa i përket çështjeve lidhur me rininë, mund të thuhet se pjesa më e madhe e tyre rrodhën nga „Platforma #1198” në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028.

Disa nga masat që u përcaktuan në „Platformën #1198” nuk përmbajnë tregues sasiorë tani që janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028. Masat e këtilla janë si për shembull numri i vendeve të reja të punës për të rinjtë që nuk përmendet aspak, numri i të rinjve të trajnuar, shuma e investimeve në konviktet studentore.

Masat për të rinjtë të parapara në „Palnin 2030” të Koalicionit Vlen janë shndërruar pjesërisht në masa të caktuara në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028. Masat për rininë në kuadër të Manifesti për Maqedoni të denjë të Lëvizjes Znam në përgjithësi janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028.

- Duke marrë parasysh formatin e Programit të punës së Qeverisë 2024 – 2028, është e mundur që një pjesë e masave të cilat nuk janë mjaftueshëm të qarta ose të saktësuara, si dhe një pjesë e zotimeve, të përpunohen më tej në kuadër të sektorëve të veçantë dhe të Ministrive. Prandaj, rekomandohet që të planifikohet dhe të zbatohet monitorimi plotësues kombëtar i përfaqësimit të masave të premtuara për rininë në strategjitë kombëtare, në strategjitë e ministrive dhe në dokumentet e ngjashme të punës me qëllim që të përcaktohet se vallë do të ketë operacionalizim plotësues të zotimeve, si dhe të atyre masave të cilat nuk janë mjaftueshëm të saktësuara apo për të cilat mungojnë treguesit e qartë.
- Rekomandohet që planifikimi i ardhshëm i Qeverisë dhe i Ministrive për vitin 2025 edhe më tej të përfshijë qëllime specifike, afate kohore, rezultate të qarta e të pritshme dhe tregues sasiore të cilat do të mundësojnë monitorimin e përmbushjes së premtimeve të dhëna.
- Rekomandohet zgjerimi i mëtejshëm i rezultateve të kësaj analize me qëllim që të arrijnë te opinioni publik d.m.th. në mënyrë të drejtpërdrejtë te qytetarët dhe në atë mënyrë qytetarët të informohen cili është vendi i prioriteteve të tyre në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 dhe të zotohen për implementimin e tyre.
- Rekomandohet organizatat qytetare të cilat veprojnë në nivel vendor të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të programeve vjetore për punën e vetëqeverisjeve vendore që të përcaktohet vallë disa nga masat për çështjet gjinore do të transponohen në nivelin vendor, në cilën formë dhe të përcaktohet plani i mëtejshëm për monitorimin e realizimit të tyre. Kjo veçanërisht rekomandohet për monitorimin e programeve të vetëqeverisjeve vendore përmes të cilave do të realizohet mbështetja e premtuar prej 250 milionë eurosh për vetëqeverisjet vendore.
- Organizatat qytetare duhet t'i përfaqësojnë kërkesat e tyre në Qeveri, ministritë kompetente dhe agjencitë me qëllim që ajo pjesë e programeve në të cilat janë përfshirë zotimet të operacionalizohet në masa konkrete dhe të njëjtat të implementohen më tej.